

MAPO

Nr. 49, nëntor 2025, viti i 20-të

ZHEJI NË MAPO

RIKTHIMI I TRETË I PAMUNDUR

IN MEMORIAM: Në nderim të drejtorit të mediave MAPO rrëfejme miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij: Bujar KAPEXHIU, Arion SULO, Alfred LELA, Ervis ILJAZAJ. Njohja, bashkëpunimi, bisedat brenda e përtej medias. Drejtori Preç ZOGAJ dhe kryeredaktori Brahim SHIMA tregojnë projektin e ri të mediave MAPO në vitin e 20-të të themelimit

SUPLEMENTET + **M** UNIVERSITAS Tirana College of Technology, si lind një kolegji teknologjie
M LETERATURA Ben Blushi, romancieri bestseller i Tranzicionit **M** IMAGO Abaz Hado: Gjithmonë e kam vrrarë mendjen pse dola piktor **M** MADAME Mira Kazhani: Jeta vendosi që të shkruaja një libër

3 COVER STORY

Zheji në MAPO

14 MAPO

Historia e një marke

M UNIVERSITAS

18 TCT

Si lind një kolegji teknologjie

23 LAERT DURAJ

KPT- TCT, lëvizja drejt së ardhmes

29 ANGJELOS LAMÇAJ

Ekselenti i Diplomës
Profesionale në TCT

M LETERATURA

32 BEN BLUSHI

Romancieri bestseller
i Tranzicionit

32 ENIRD MALILE

dhe absurdi i njeriut të zakonshëm

37 GANI MEHMETAJ

Janë disa vepra që do t'i hiqja
nga Antologjia e letërsisë shqipe

M IMAGO

40 ABAZ HADO

Gjithmonë e kam vrarë mendjen
pse dola piktor

45 "AMAKRES"

Enveri dhe Mehmeti, piktura
e humbur e Fatmir Haxhiut

M MADAME

46 MIRA KAZHANI

Jeta vendosi që të shkruaja
një libër

49 DRITA KRUJA

Bëj mirë, pa zhurmë

51 SEVASTI QIRIAZI

Pionierja e arsimit për vajza

Piktura në kopertinën e MAPO:

Portret për Artur Zhejin, nga Abaz Hado,
posaçërisht për këtë event!



15 KORRIK 2025, ORA 20:30. FOTO E FUNDIT E ZHEJIT, ME BOTUESIN HENRI ÇILI, GJATË DISKUTIMEVE PËR KTHIMIN E TRETË SI DREJTOR I MEDIAVE MAPO, NË VJESHTE TË 2025-S

MAPO

Botues: **ÇILI CIVIC PROJECT. SHPK** / Drejtor: **PREÇ ZOGAJ**

Kryeredaktor: **BRAHIM SHIMA** / **Bashkëpunuan:** Suadela Balliu, Luiza Pinderi, Arianiti Muraçi, Aulona Menalla, Albana Cenaj / **Fotografia:** **HAMERALDI AGOLLI** / **Design:** **BESNIK FRASHNI** / www.mapo.al

E përmuajshme, politike, shoqërore, kulturore, nr. 49, nëntor 2025, viti i 20-të, çmimi 500 L

Themelues i elegancës në median e shkruar

PREÇ ZOGAJ
Drejtor i MAPO



Është nder dhe përgjegjësi për mua që të jem pa-sues i të paharruarit Artur Zheji në këtë nismë të gazetës MAPO, gazetë e vjetër dhe me emër, që vjen e ndërthurur me gazetën e re Liberale. Të dyja kanë të përbashkët boshtin ideologjik të liberalizmit të djath-të. Gazeta MAPO do të jetë një gazetë e lajmit dhe men-dimit, përmes një stafi gazetarësh profesionistë dhe një skuadre opinionistësh, analistësh dhe ekspertësh nga të gjitha fushat që mendoj se nuk i ka asnjë media.

Besoj se do të jetë një gazetë e drejtë, etike, qytetare, libertine në boshtin ideologjik, por e hapur për mendimin ndryshe dhe për diversitetin. MAPO do të jetë një gazetë kritike me qeverinë dhe qeveritë, por pa vënë per-de në sy për të mos parë gjërat e mira që bëhen. Ajo do të jetë një gazetë që do të mbështesë pa kushte integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, drejtësinë e re dhe kështu me radhë. Ka një mendim mjaft të përhapur në Shqipëri, sipas të cilit një media në vendin tonë nuk mund t'ia dalë pa qenë pjesë e ngushtë e një subjekti politik apo e një

grupi interesash që e përdor për presione, favore apo për të luftuar konkurrentët e vet, e aq më keq për të vënë gjo-ba. MAPO nuk do të jetë e tillë. MAPO e përjashton veten nga çdo konflikt interesi. Ajo do të jetë një media e nismës së lirë, një media e lirive dhe synon që të bëhet zëri i qytet-arëve dhe njerëzve të thjeshtë.

Zhejin e kam takuar për herë të parë në Itali. Ai ishte gazetar i Radio Radikale në Itali, ndërsa unë kisha shkuar në një vizitë. Kisha dëgjuar për të. Ishte djalë me intere-sa të gjera kulturore. Më vonë e kam takuar kur drejton-te një emision shumë të rëndësishëm në TVA për luftën në Kosovë. Kam qenë i ftuar shpesh herë aty. Kemi pasur sintoni të madhe në lidhje me qëndrimin ndaj zhvillimit epokal që ndodhi në atë kohë me bombardimin e Serbisë nga NATO dhe çlirimin e Kosovës.

E kam përjetuar me dhimbje të madhe ndarjen e tij nga jeta. Mendoj se ai ishte një nga gazetarët opinionist që themeloi elegancën në median e shkruar shqiptare. Shkrimet e tij mund t'i kuptoje se i kishte shkruar ai, ed-he nëse nuk vendoste emrin.

Në vijim na ka lidhur leximi i librave. Sidomos i poezisë. Nuk e harroj kurrë: Kur i dhashë një librin tim poetik me titull “Kalimi”, pasi e lexoi ai më tha me atë mënyrën e tij: “Tani e kuptova enigmën tënde. Ti duket sikur je i përf-shirë kokë e këmbë në këtë botën e medias, opinionit, de-batit, por na mashtron. Sepse gjen gjithnjë kohë dhe nx-jerr kokën mbi re. Atje shkruan këto që ke në libër”. Ishte mjeshtër për të bërë përcaktime të kësaj natyre, për kë-do që njihte dhe donte.

ZHEJI NË MAPO

RIKTHIMI I TRETË I PAMUNDUR

IN MEMORIAM: Në nderim të drejtorit të mediave MAPO rrëfej në miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij: Bujar Kapexhiu, Arion Sulo, Alfred Lela, Ervis Iljazaj. Njohja, bashkëpunimi, bisedat brenda e përtej medias. Drejtori Preç Zogaj dhe kryeredaktori Brahim Shima tregojnë projektin e ri të mediave MAPO në vitin e 20-të të themelimit



Artur Zheji iu bashkua gazetës MAPO, fillimisht në vitin 2011, dhe më pas sërish në vitin 2015. Ishte parashikuar një rikthim i tretë në vjeshtën e 2025-ës. Në muajin qershor ai kishte biseduar dhe pothuajse ishte dakordësuar për kthimin si drejtor i mediave MAPO. Fati u tregua më “lakmitar”. Zheji u nda nga jeta në gusht të këtij viti duke lënë pas emrin e një trashëgimie të vyer, ndërtuar gjatë katër dekadave të vrullshme si gazetar.

Ai u bë një nga zërat më të njohur të gazetarisë shqiptare në vitet ‘90-të. Fillimisht si korrespondent në Romë për “Koha Javore”, më pas si bashkëpunëtor i Radio Radikale në Itali, ku mbulonte zhvillimet ballkanike. U rikthye në Shqipëri gjatë luftës së Kosovës për të moderuar emisionin e famshëm “Luftë apo Paqe në Kosovë”, në TVA - një program që fitoi audiencë të jashtëzakonshme.

Nga vitet 2002 deri në 2006, Zheji shërbeu si Drejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), duke u përpjekur të modernizonte një institucion të rëndësishëm publik.

Në vitin 2010, ishte një nga figurat më të zëshme të Lëvizjes në Mbrotjtje të Kushtetutës, që kundërshtoi ndryshimet e “paktit Nano-Berisha”, i pandikuar nga interesat politike dhe i përkushtuar ndaj parimeve të lirisë kushtetuese.

Në vitet 2011–2016, Artur Zheji drejtoi gazetën MAPO, duke sjellë një frymë të re analitike, debat intelektual

al dhe qartësi profesionale. Vitet e fundit erdhi për publikun e gjerë si drejtues i talk-show-t “360 Gradë” në ekranet e Ora News dhe ABC News Albania, një platformë ku debati politik e kulturor merrte formën e një teatri intelektual, ndërsa ai qëndronte në rolin e udhëheqësit të mendimit.

Dimensioni i intelektualit, gazetarit, drejtuesit, vjen i qartë dhe shpërfaqet i plotë përmes rrëfimeve të atyre që punuan dhe bashkëpunuan me të në vitet e arta të MAPO-s. Kryeredaktorë, drejtues, analistë, njerëz të artit dhe shkrimt, emra që kanë bashkëshoqëruar rrugëtimin e kësaj medieje me ndikim në Shqipëri, sjellin njohjen ndër vite me emrin, punën dhe njeriun, por mbi të gjitha rrëfejnë bashkëpunimin me drejtuesin Artur Zheji.


Takimet me Zhejin ishin takim me diturinë

Nga Bujar Kapexhiu, bashkëpunëtor

Njohja e parë me të ndjerin Artur Zheji nis herët, që kur ai ishte fëmijë, për shkak të njohjes sime me të atin, Petro Zhejin. Pra, njohja fillestare me të ka qenë si djali i Petro Zhejit. Më vonë njohja vijoi në Akademinë e Arteve ku Arturi studioje në fakultetin e Artit Dramatik dhe unë isha pedagog. Njohja dhe shoqëria u thelluan më tej kur ai ishte drejtor i RTSH-së dhe unë kisha programe e aktivitete të ndryshme në televizion, gjë që bënte të kishim kontakte të herë pas hershme.

Ajo që ishte më e rëndësishmja, më e madhja dhe që konsolidoi shoqërinë tonë, të cilën mund ta quaj një shoqëri shumë të afërt, ishte gazeta MAPO. Ai ishte drejtor, ndërsa unë i përditshëm me karikaturën time në faqen e parë. Kontakti ka qenë pastaj i përditshëm dhe prej këtyre takimeve kam mbresa dhe kujtime nga më të ndryshmet. Çdo takim me Artur Zhejin unë e quaja një takim me diturinë, fisnikërinë, me horizontet e shumta që kishte ai, duke qenë se të jepte shumë mundësi të lundroje në këto hapësira. Kishte një karakteristikë tepër interesante, modestinë. Megjithëse e njihje shumë mirë problemin, karikaturën që unë bëja, ai sërish ishte modest. Gjithmonë të hapte rrugë, njëjtë si xhentëlmënët që të lënë të kalosh. Në ndonjë moment të caktuar mendimet tona ishin edhe të ndryshme, por mirësjellja, dashamirësia e tij të lehtësonte kalimin, duke i dhënë rëndësi mendimit që t'i kishe. Ndërhynte me shumë delikatesë dhe finesë në diskutimin profesional.

Në çdo bisedë me Arturin shikoje dhe zbuloje gjëra vërtet interesante që nuk të kishte shkuar mendja. Ishte ai që me shumë fisnikëri, delikatesë, të drejtonte drejt një mendimi të caktuar, për të cilin ai ishte i bindur. Pavarësisht se ti qëndroje me bindje në idenë tënde, ai me



shumë fisnikëri tërhiqej, por ajo tërheqje dhe hapje e rrugës të çonte në reflektim. Të bënte ty të kuptoje se ai kishte të drejtë.

Gjithçka që diskutonim me Arturin më jepte kënaqësi të veçantë. I pëlqente shumë humori dhe satira. Diskutonim me shumë profesionalizëm dhe aty kuptoja që me të vërtet mendimet e tij më ndihmonin që të shikoja një kënd original për një problem apo ngjarje të caktuar. Flisnim shumë për politikën. Herë pas here binim dakord, por ndanim edhe mendime të ndryshme. Ai ishte shumë tolerant, të hapte rrugë, dhe në organizimin e bisedës të tërhiqte gjithmonë pranë vetes. Ti dashur pa dashur, pa e ndjerë, nëse në fillim e kishe kundërshtuar, në fund bi-



je dakord me të. Kjo sepse analiza, arsyetimi, argumentet ishin kaq të forta, kaq të bazuara sa të bindnin.

Vlera e tij si analist ishte padyshim e paçmuar. Ishte ndër ata analistë që unë e dëgjoja me vëmendje. Jo vetëm e dëgjoja, po çka është më e rëndësishme, e besoja. Mund të dëgjosh shumë, por janë sezonalë. Ai në çdo problem kishte një bazament të fortë njohurish dhe i paraqiste kaq bukur para teje sa ti me vërtet mësoje shumë.

Në shumë karikatura të mia është edhe ndikimi i tij, me zhvillimin dhe thelbin e problemit politik. Ishte një bashkëpunim i afërt dhe miqësor. Përtej marrëdhënies profesionale shumë të frytshme, kujtoj gjithmonë me kënaqësi anën e tij njerëzore, dashamirësinë, miqësinë, përkushtimin që jepte në shoqëri. Këtë e kam ndjerë në një moment të jetës sime kur i vetëm ndodhesha në stacionin e trenit në Romë dhe nuk dija ku të shkoja. Krejt rastësisht u takova me Arturin dhe ishte ai që më bëri shoqëri, duke m'i lehtësuar ato ditë të qëndrimit atje. Ishte një mik i vërtet që jepte për shoqërinë me shumë sinqeritet. Zyra e tij në Radio Radikale ndodhej pranë stacionit të trenit. I vizitova ato ambiente dhe kalova kohë të jashtëzakonshme.

Unë herë pas here në karikaturën time merresha me personazhe politike, por në një moment erdhi rasti që të përfshija Zhejin. E kam bërë me shumë kënaqësi. Ishte periudha kur ai i mbante flokët pak të gjata dhe nga ana figurative kjo më jepte dorë që portreti i tij të dilte klasik. Ai natyrisht e pëlqente mënyrën si e pasqyroja dhe kjo më gëzonte, pasi kuptoja që e kisha bërë me vërtetësi dhe dashuri. Edhe politikanët i kam pikturuar me shumë dashuri dhe respekt, pa i denigruar, duke i sjellë shumë afër realitetit dhe karakterit të tyre.

Zheji kishte një gjë interesante që nuk e ndeshje te të tjerët. Në momentin që thoshte mendimin e tij për një çështje politike dhe ti nuk bije dakord me të, ai nuk të ndërpriste. Të dëgjonte me vëmendje dhe pastaj mjeshtëria e tij fillonte të ndërtonte pjesën, momentet, arsyetimet dhe të gjitha këto të çonin drejt mendimit të tij. Me mënyrën sesi fliste, dashur padashur ai të thithte dhe të bënte të bashkoheshë lehtësisht me atë që ai thoshte.

Intelektuali që tejkalonte median dhe MAPO-n

Arion Sulo, ish- kryeredaktor i MAPO

MAPO doli si gazetë në vitin 2010. Zheji ka ardhur për herë të parë si drejtor në vitin 2011. Ardhja e tij në një gazetë një vjeçare, pasi kishte punuar në Radio Radikale, kishte bërë emisione shumë të rëndësishme, kishte përvojë si analist, në një sens i rrinte pak ngushtë Zhejit si staturë. Nga ana tjetër, ardhja e tij ishte një vazhdim, ose më mirë një rikthim i drejtorëve të rëndësishëm të mediave shqiptare në vitet '90-të, siç ishte Ben Blushi, Armand Shkullaku, Andi Bushati, Carlo Bollino. Ardhja e një drejtori të tillë në këtë gazetë shënoi një rikthim që nuk kaloi pa u vënë re në gjithë mjedisin mediatik shqiptar, sepse në atë kohë televizioni kishte filluar të merrte hov dhe të kalonte shtypin e shkruar.

Zheji erdhi në MAPO si drejtor herën e parë, pasi kishte bërë pothuajse një 10-vjeçar në Radio Radikale në Itali, ku dhe ai vetë, jo vetëm që e kujtonte me krenari dhe nostalgji, por e mbante si një periudhë të artë të karrierës së tij. Zheji u bë lobuesi më i fuqishëm në Itali i çështjes shqiptare. Radio Radikale në atë kohë dhe politikanët e Partisë Radikale, por dhe partitë e tjera italiane u lobuan dhe u përpunuan për mirë nga Zheji për çështjen shqiptare dhe kosovare.

Që në atë kohë, jo vetëm për bombardimet e 1999-ës dhe pastaj çlirimin e Kosovës, por në Radio Radikale, në kontaktet, intervistat dhe analizat e Zhejit ishin tezat kryesore për çlirimin e Kosovës, për të drejtën ndërkom-bëtare të shqiptarëve të Kosovës, që më tej i mori politika shqiptare por edhe ajo italiane. Kjo është një meritë e



jashtëzakonshme që Zheji e kujtonte gjithmonë me krenari.

Së dyti, gjithmonë për rolin e tij si gazetar, ai erdhi në MAPO pasi kishte qenë drejtues i emisionit “Luftë apo Paqe” në TVA-në e dikurshme, një nga dy televizionet më të mëdha të asaj kohe dhe u bë qendra e debateve, në një kohë që debatet nuk kishin marrë akoma formën që kanë sot. Ishin shumë larg, ishin në hapat e parë. Aty kanë parakaluar të gjithë luftëtarët e dikurshëm të UÇK-së dhe shumica e politikanëve që drejtojnë Kosovën, përfshirë ish-krrerët e UÇK-së që janë në Hagë, përfshirë politikën shqiptare, nga kryeministri deri te deputetët, studiues, historianë, ekspertë, luftëtarë.

Zheji në atë periudhë, në vitet 1998- 2000, me emisionin e tij u bë i njohur masivisht për publikun shqiptar, sepse ai për politikën shqiptare, për rrethet intelektuale, për rrethet mediatike ishte tashmë i njohur me kontaktet, korrespondencat që kishte nga Shqipëria në Itali dhe më gjerë, me Tiranën e viteve '70-'80. Zheji njihje çdo personazh publik, të zëshëm apo të pazëshëm të asaj kohe, pasi kishte pasur një rini dhe formim në Universitetin e Arteve, por dhe për shkak të prejardhjes, të familjes së tij, të shkrimit, të poezive, të letërsisë.

Bashkëpunimi im në MAPO me Zhejin, në rolet ai drejtor dhe unë kryeredaktor, ka qenë bashkëpunimi më i mirë që kam pasur në shtypin e shkruar dhe nuk e them këtë sepse Zheji nuk është më, fatkeqësisht, por sepse e vërteta ashtu ishte. Bërja e gazetës MAPO, në bashkëpunim me Zhejin, ishte gjëja më e thjeshtë për ne. Zheji ishte një njeri dhe një figurë e tillë intelektuale që tejkalonte median dhe MAPO-n.

Më në kujtesë kam takimet e bisedat e gjata të cilat i strehonte në tre fusha: mitologji, filozofi dhe besim. Ishin tre referenca, ose tre jetë që Zheji i jetonte përveç jetës reale. Si të gjithë njerëzit që kanë një botëkuptim të vetin për botën, një marrëdhënie krejt origjinale, ai kishte jetesën e ritmin e tij. Nuk prekej Zheji nga një ngjarje e rëndomtë që në gazetë mund të dilte titull i madh, për shkak të përpunimit dhe reflektimit të thellë, referencës dhe jetës së tij në këto tre fusha.

Sa i përket drejtimit të gazetës them se Zheji u ngjiz shumë natyrisht me MAPO-n, sepse ajo ishte afirmuar që në fillimet e saj si një gazetë me qëndrim editorial të qartë djathtas, pro tregut, pro ShBA-së, pro integritimit evropian e BE-së, dhe Zheji i përcillte shumë mirë këto dhe ndante të njëjtën pikëpamje në politikën e brendshme.

Një nga momentet ku ky dualizëm, kjo shkrirje u bë më e dukshme ishin zgjedhjet vendore të Tiranës në 2011, ku edhe gazeta edhe Arturi shpallën publikisht mbështetjen dhe qëndrimin e tyre për Lulzim Bashën. Ishte një betejë, përveçse elektorale, dhe në gazetari në kuptimin e përballjes së ideve, të argumentimit, të ndryshimit që duhet të ndodhte, betejë e cila u fitua nga Zheji dhe nga MAPO.

Bisedat e gjata me Zhejin për gazetarinë dhe pothuajse për gjithçka, për Tiranën e viteve '70-'80, për jetën dhe tranzicionin e asaj kohe, për librat e ndaluar, për periudhën e emigracionit, por gjithmonë kjo e ndërthurur me aktualitetin, emigracioni i tij dhe emigracioni i shqiptarëve, çfarë ndodhte këtu dhe si duhet të ishte ndryshe, ishin ato që ndërthureshin dhe rrinin shumë mirë edhe me procesin e gazetëbërjes, sot një zeje në zhdukje në Shqipëri, si në të gjithë botën.

Kjo herë pas here krijonte një lloj depresioni. Në fakt, gazeta si gjini e medias e ka brenda depresionin e gazetarëve dhe të punuarit gjatë. Patjetër, këto ishin pjesë e bisedave tona, se ku po shkon media, ku po shkon gazeta, çfarë mund të bëhet për ta shpëtuar. Pastaj ktheheshim te MAPO, si do ta vazhdojmë, ku do ta çojmë, si është, si duket. Zheji kishte një shprehje, një moment që nuk do ta harroj: "MAPO e madhe nuk është, por e tillë ndihet".

Më i miri i analizës politike

Ervis Iljazaj, ish- drejtor i MAPO

Unë Arturin e kam njohur në dy dmiensione. Për herë të parë e kam hasur kur isha student i Shkencave Politike në Itali dhe ndiqja çdo emision politik. Zheji ishte një nga analistët e mi të preferuar, jo se bija dakord gjithmonë me ato që thoshte, por me mënyrën si i thoshte. Si student i ndiqja shpesh debatet politike në Shqipëri dhe më bënte përshtypje mënyra se si ai artikulohej. Kishte një gjë të veçantë nga analistët e tjerë. Metafora, mjeshtëria e fjalës që zotëronte, për mua e bënte një nga analistët më elegantë të debatit publik shqiptar.

Fati donte që ta njihja dhe nga afër. Në vitin 2013 unë fillova punë si pedagog i Shkencave Politike në UET. Aty ishin dhe zyrat e MAPO-s. Kam shkruar artikullin tim të parë në vitin 2015 kur Zheji ishte drejtor. Nuk e mbaj mend tamam titullin, por shkrimi kishte të bënte me ngjarjet politike. Të nesërmen kur e pashë të botuar u gëzoja sepse ishte artikulli im i parë publicistik në një gazetë të rëndësishme në Shqipëri.

U shkëmbeva me Arturin në oborrin e UET dhe gjëja e vetme që më tha: "Nuk ishte keq artikulli". Nuk dija si ta kuptoja, si kompliment apo si kritikë. Pyes kolegët dhe

sipas tyre këto fjalë ishin tregues që artikulli i kishte pëlqyer sepse Zheji nuk bënte shumë komplimente.

Arturin e kam njohur më tej edhe kur rrinim në zyrat e MAPO-s. Kur uleshim për dreka dhe darka shoqërore, kishte gjithmonë diçka të re që do ta mësoje prej tij. Ajo që më bënte përshtypje, ishte se, ndryshe nga të tjerët, ndoshta dhe për shkak të formimit të tij si regjisor, njihnte mirë natyrën, intrigat dhe prapaskenat e politikës. Pas çdo ngjarje apo evenimenti politik shihte një prapaskenë. Dhe kishte të drejtë. Në fund të fundit, politika, ajo që shfaqet në publik nuk është asnjëherë e vërteta. Politika nuk thotë asnjëherë publikisht atë që bën në të vërtetë.

Edhe Zheji e dinte këtë mirë dhe pastaj e përcillte me elegancë në studiot televizive. Kjo ishte veçantia e tij. Ishte një erudit, kishte njohje të përgjithshme në shumë fusha, filozofi, sociologji, politikë, ekonomi. Kjo i jepte një armë shtesë në raport me të tjerët. Kultura e erudicionit i vinte nga trashëgimia familjare, nga ambienti ku ishte rritur, nga leximet, arsimimi etj.

Një nga arsyt pse kam pranuar ta drejtoj MAPO-n ishte sepse drejtor i saj kishte qenë edhe Arturi. Ai ka pasur një ndikim të unë përmes medias dhe debateve. Unë mendoj që debatit publik shqiptar do t'i mungojë arsye-



timi i Arturit, do t'i mungojë eleganca e tij në debatet politike. Po të ndjekësh me vëmendje debatet ku ka marrë pjesë si analist, debutues, por edhe si moderator emisionesh, ai asnjëherë nuk ulërinte nëpër studio, nuk bërtiste, nuk ofendonte. Mendohej që t'iu imponohej debateve politike e të thoshte arsyen e tij me argument. Kjo është e rrallë në debatet publike shqiptare, të cilat shpeshherë karakterizohen nga zhurma, nga kaosi.

Karizma në media përbëhet edhe nga pamja. Ai kishte një staturë imponuese, trupmadh, i gjatë. Përveç kësaj, kishte edhe forcën e argumentit, kishte metaforën. Besoj që, fatkeqësisht, Shqipërisë i ka ikur më i miri i analizës politike.

Më kujtohet një batutë e famshme sa i përket gazetës MAPO, me të cilën ne qeshim edhe sot kur e kujtojmë. Duke diskutuar te zyrat e MAPO-s, Robert Rakiplari i thotë Arturit me nota ironie: "Kush e thotë këtë gjë, gazeta e madhe MAPO?" Zheji iu përgjigj: "Gazeta MAPO vërtet nuk është shumë e madhe por zhurmën e bën të madhe". Dhe unë mendoj se zhurmën e bënte ngaqë kishte drejtor Turin. Sa herë që ai shkruante një editorial apo jepte një tezë politike, nuk mund ta anashkaloje. Gjithmonë shkaktonte debat.

Moikani i fundit i debatit publik në qytet

Alfred Lela, ish-kryeredaktor i Revistës MAPO

Zheji nga qyteti. Personazhi nga qyteti, që shpjegon qytetin, ua bën me dije të tjerëve por dhe e mbart qytetin si një lloj thesari, për t'ua trashëguar brezave të lexuesve, por edhe brezave biologjikë.

Unë isha zv. kryeredaktor i gazetës MAPO, më vonë u bërë kryeredaktor i Revistës së përmuajshme MAPO. Zheji ishte drejtor i gazetës MAPO, kështu që kontaktet me të ishin të përditshme. Ai rrinte në një zyrë të madhe që ishte bërë enkas për të, sepse Zheji e meritonte, i duhej dhe i shkonte përshtat një zyrë e tillë, një hapësirë shumë e madhe në kat të dytë. Zyra ime ishte një kat më lart ku gjendej redaksia dhe e mbaj shpesh mend veten duke zbritur shkallët për të shkuar te Zheji kur kishim mbledhje, kafe apo takime dhe gjithmonë e gjeje me cigare. Kishte një makinë kafeje Lavazza, e bënte kafën aty dhe gjithmonë e gjeja të rrethuar nga gazetatat, revistat, librat dhe me cigare në dorë.

MAPO bëri historinë e vet, një histori të rëndësishme, mendoj unë, në shtypin shqiptar dhe ishte gazeta që iku pa marrë fund të gjitha gazetatat. MAPO pati ndriçimin me teorik. Erdhi si një gazetë, dhe pse ishte e vogël në njëfarë kuptimi, ishte e madhe në ndikim, influencë, dhe fakti, rrethanat e sollën ashtu, që ajo të "vdiste" para se të vdisnin të gjitha gazetatat. Sot jemi në kontekstin që gaze-

ta nuk ka më. Në kioska kanë mbetur 2-3 të tilla me tirazh të reduktuar. Në këtë sens, më mirë që MAPO iku si gazetë në kohën kur ishte e hijshme sesa të priste dhe ta kishte fundin e trishtë që patën gazetatat e tjera.

Me Zhejin e ruaja komunikimin, por para 3 vitesh rasisëm në një udhëtim në Zvicër, një udhëtim që e organizonte Philip Morris. Më kujtohet kur ishim në një qytet të Zvicrës dhe ai po shikonte të rinjtë, ndërtesat, jetën që vibronte dhe në një moment më tha: "Ah mor Lela, një gjë të tillë do të doja edhe për fëmijët e mi". Kjo më mbeti thujtë si një ofshamë e tij. Më këtë ai zbuloi jo vetëm faktin që çdo prind do më të mirën për fëmijët e vet, por zbuloi edhe ato mungesa, që ne shqiptarët i kuptojmë kur dalim jashtë vendit që duam shumë.

Ishte ofshama e intelektualit që praktikisht i ka arritur gjërat. Zheji nuk ishte një njeri i paplotësuar, as në karrierë, as në gjërat e tjera, por megjithatë kur është në fund të zemrës, i relaksuar, e ruan një derë. Kjo ishte ana njerëzore e Zhejit, prandaj subkoshienca ime çoi te titulli i shkrimit "Zheji nga qyteti", pas ndarjes së tij nga jeta.

Anën profesionale pastaj ia njohin të gjithë. Kanë parë debatet, polemikat, shkrimet, të gjithë punën e tij për Radio Radikale dhe luftën në favor të shqiptarëve të Kosovës. Zheji kishte aurën e një njeriu nopran dhe distancues. Nga larg këtë reflektonte, por po të punoje me të e shihje se ishte babaxhan. Pra ishte kënaqësi dhe ta bënte të lehtë punën. Nuk kishte kurrë një marsh të pestë për t'i kërkuar gjërat. Edhe me marsh të dytë dinte t'i kërkonte dhe t'i merrte gjërat. Ishte një njeri që e dinte peshën dhe arritjet e veta por dinte dhe kufijtë etike, shoqërore, si të vetët si dhe të tjerëve. Prandaj them që ishte qytetar, ndër ata që janë drejtues apo mes drejtuesve që kam punuar ndër vite.

Zheji ishte oratori, demagogu. Ka të tjerë që kanë shkruar për tekstin e tij por unë do ta veçoja më shumë si Zheji polemist. Mendoj që Zheji polemist ishte i pakrahasueshëm. Mënyra si polemizonte, me qetësinë, me diturinë dhe me posturën, është ajo çka do t'i mungojë debatit publik në Shqipëri. Impostimi i tij si polemist, me dijet, të pasuruar me etikë, pa fyer, e spikaste atë. Nuk e kishte qëllim ta mundte kundërshtarin, kishte qëllim ta pasqyronte të vërtetën e tij për publikun, pa kaluar mbi "trupin e vdekur" të kundërshtarit. Fakti që vinte nga teatri e bënte atë polemist dhe orator më të mirë dhe dramaturgjia ia kishte dhënë këtë përmasë. Me këtë anë të tij do t'i mungojë qytetit si profil publik.

Puna që ka bërë ai me Radio Radikale, duke prezantuar në Itali një çështje si ajo e pushtimit serb dhe reprezaljet gjatë luftës së Kosovës, ka qenë e rëndësishme për kombëtarë. Kjo nuk duhet harruar. Zheji me një çantë, ku



kishte radion dhe mikrofoni e atyre kohëve, që vraponte për të kapur lajmin e për të marrë intervista, është imazhi që mbaj mend nga koha kur isha student. Kujtoj Zhejin që vraponte për të kapur atë gjë që kishte rëndësi.

Sot koha është e tillë që nuk ka më gazetarë që duan të thonë gjëra të cilat kanë rëndësi. Ka gazetarë apo njerëz publikë që duan të thonë gjëra që bëjnë përshypje, janë gallata dhe kapin clickbite. Zheji përfaqëson të kundërtën, autorin, polemistin e gjërave që kishin rëndësi. Në këtë pikë, më duket si moikani i fundit i debatit publik në qytet.

Aristokrati i ekranit

Abaz Hado, bashkëpunëtor

Me Turin jam njohur herët, që kur kemi qenë studentë. Ai ishte me i ri se mua, ishte për dramaturgjë dhe regji të Artet. Një djalë simpatik, elegant, që vërtet dinte të binte në sy. Pastaj jam njohur më vonë, kur Turi u bë drejtor i Radio Televizionit Shqiptar, por e kisha hasur edhe më përpara kur ka ardhur te News 24 dhe bëri një intervistë shumë interesante me një nga kryetarët e Agimit të Artë.

U prit me entuziazëm brenda televizionit, por në prapaskenë, nga dëshmitë mësova se realizimi kishte qenë shumë i tensionuar. Por ai arriti ta përballonte si duhet, me qetësinë dhe formimin e vet nga Radio Radikale, ndërkohë që regjia e kishte bërë t'i kuptonte më mirë gjërat. Kur filloi emisionin "360 gradë", kjo ishte një nga intervistat më interesante, e cila tërhoqi një audiencë të jashtëzakonshme.

Me Turin më ka lidhur puna dhe në televizionin publik. Ai ishte drejtor dhe në pjesë e Këshillit Drejtues dhe komunikoi shumë mirë, edhe për shkak të njohjes së hershme. Aty kuptoja, në perceptimin tim, se ishte një njeri shumë i aftë, që e kuptonte situatën dhe ishte largpamës. Kur ai ishte në krye të punës, ishte vërtet ekselent.

Në konsideratën time personale por dhe në përgjithësi, me çfarë kam parë në ekran, duke qenë se jam pjesë e tij dhe më intereson shumë kjo pjesë e komportimit, pra e atij që bën emisionin dhe atij që e sheh, gjithmonë më është dukur se Turi i imponohej audiencës, jo vetëm me qëndrimin, me diturinë, por me aristokracinë e qëndrimit. Ai kurrë nuk ofendonte, nuk e ngrinte zërin, por kishte fjalë dhe mendim të thellë. Duke qenë i dramaturgjisë



dinte ta përdorte fjalën. Ai u dallua mbi të tjerët me emisionin që bënte, jo vetëm si polemist, si analist, si moderator, por diti të kapë problematika shumë të rëndësishme. Nuk e ktheu debatin në një debat banal, por trajtonte çështje madhore për vendin, rajonin apo botën.

Ishte largpamës, një njeri shumë i ditur dhe shumë i lexuar. Këtë nuk e kishte të pasqyruar në mënyrë të përciptë por ishte i thellë në atë që thoshte. Po ta dëgjoje me vëmendje dramaturgjinë e fjalës, Turi e kishte gjuhën shumë lakonike, fjalitë shumë të qarta, shqipen shumë të pastër. Kjo edhe për shkak të kulturës familjare, ndikimit të të atit dhe anëtarëve të tjerë të familjes Zheji, të cilët shin korifenj të kulturës shqiptare. Turi kishte një trashëgimi gjenetike.

Ajo që më pëlqen, si përfaqësues i artit pamor, është fakti që ai nuk i ktheu asnjëherë emisionet e tij në një debat ofendues, fyes, por orientonte dhe dominonte. Turi më ka pëlqyer gjithmonë sepse e zotëronte edhe me pamje ekranin. I jepte nur. Kishte një pamje që impononte dhe dominonte mbi të ftuarit. Ishte mjeshtër i vendosjes së balancave, e shpërndarjes së fjalës dhe mënyrës si e shtronte idenë. Kujtoj emisionet e luftës, ku pasi shtron-

te idenë, fliste me ekspertë të posaçëm, me njerëz që ishin përtej ekranit apo televizionit. Ai dinte ta orientonte shumë mirë temën dhe emisionin duke u bërë një shembull. Këto nuk vijnë vetvetiu, por sepse njeriu rritet dhe formohet i tillë, e njëkohësisht ka interes që gjërat t'i bëjë në mënyrën më të mirë të mundshme.

Nëse do t'i vija një etiketim do ta cilësoja aristokrati i polemikës dhe moderimit të emisioneve televizive. Duke qenë se gazeta MAPO rikthehet me kujtimin e ish-drejtnesit të saj, me emrin dhe fytyrën e Zhejit, unë mora një spunto për t'i bërë një portret, sepse e ndiej detyrim ndaj atij njeriu që dha gjithçka, krijoi një model se si njeriu duhet të komunikojë me publikun. Kishte humor dhe sarkazëm. Ishte shumë goditës me fabula, me fjalë të zgjedhura dhe të 'detyronte' që përballë tij të ruaje vigjilencën. Gjithsesi, sarkazma e tij ishte pozitive.

Përveç anës së komunikimit viziv, ai kishte dhe një penë shumë të mprehtë falë diturisë, inteligjencës së lartë, posedimit të një kulture, e cila vërtet është dominante kur ajo shpallor gjithë fuqinë e një njeriu të caktuar, në momentet kur një vend ka nevojë për gjëra të tilla. Turi ndodhej aty në momentet kur ky vend kishte nevo-

jë për një intervistë të fortë në atë batakun e lëvizjes fashiste në Greqi, kur ishin problemet e Kosovës, apo edhe problemet në Ukrainë. Turi shkëlqeu në të gjitha iniciativat e tij, aftësi e njerëzve që kanë fuqi kulturën, lehtësinë e shikimit dhe fuqinë e analizës, e cila është domeni i intelektualëve të klasit të parë.

Turi ishte njeri me humor, me batuta, gjë që e shfaqte shpesh në darkat apo mbledhjet që kishim me të. Ishte miqësor dhe pranonte anën e marrëdhënies njerëzore. Ishte veti shumë e mirë e tij. Ishte shumë korrekt në marrëdhëniet e punës. Kur i thoshe diçka, menjëherë e kuptonte rëndësinë e saj. Dukej sikur të krijonte një distancë, por në fakt ajo ishte një distancë provokuese pozitive.

Shpesh i thoshim: "Je moderator i shkëlqyer, je gaze-tar, bëj emisionin tënd". Por e kishte më mirë të punonte se sa të shfaqej. U fut pastaj në televizionet private dhe solli një kulturë që e kishte marrë nga Italia, nga Radio Radikale. Mbartte mënyrën si konceptohet një marrëdhënie e punës për të çuar një rezultat konkret aty ku kërkohet, ku duhet dhe ku duhet të arrihet.

Bashkonte babaxhanin, bohemin dhe njeriun popullor

Fitim Zekthi, pjesë e MAPO

Artur Zheji apo Zheji siç ne e kemi thirrur gjatë kohës kur takoheshim apo punonim bashkë, ka qenë një prani shumë e madhe në MAPO. Jo thjesht si drejtor, pasi ky pozicion nuk ishte detyra monumentale e tij, në kuptimin e të qenit burokrati, njeriu që drejtonte punën e përditshme. Ka qenë prani e madhe sepse përcaktonte linjën editoriale, mënyrën se si duhet t'i qaseshe një aspekti politik, njerëzor etj.

Zheji kishte një mënyrë komunikimi që do të donte ta kishte kushdo që mban role si të tijat. Kushdo që është në ambiente të tilla do ta donte një njeri si Zheji, që komunikonte në atë mënyrë. Ishte njeri babaxhan, njeri i thjeshtë. Koncepti ynë i hershëm për të, si një bohem, ishte i vërtet, jo në sensin se jetonte si i tillë por sillej si bohem. Zheji vinte nga arti, ishte shkrimtar, njeri me lexime të shumta, me njohje të mëdha për mitologjinë, letërsinë.

Ka qenë prani shumë e madhe në MAPO. Në fakt, unë e kam njohur më herët se ta njihja në MAPO. Ka qenë viti '98-'99 kur ai punonte te TV Arbëria dhe bënte një emision të jashtëzakonshëm. Ishte një emision që fliste vetëm për luftën në Kosovë dhe aty kupton se ai kishte një qasje që pakkush e kishte në botën e medias shqiptare. Deri në momentin kur ndërroi jetë, ka qenë një

njeri që u shoqërua edhe nga ky dimension i çështjes kombëtare dhe dashurisë për kombin.

Zheji kishte tre cilësi të lakmueshme. Ishte mbrojtës i madh i lirisë ekonomike, politike dhe njerëzore. Lirinë e kishte pjesë të vokacionit dhe e shfaqte vazhdimisht në shkrime apo editoriale. Dimension i dytë ishte lidhja me kombin. Gjithmonë fliste për çështjen e shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë, të Greqisë, nga këndi i njeriut të mbrojtur me konceptin e lirisë. Tjetra, që është shumë e rëndësishme dhe e rrallë, ai kishte këndin e një njeriu që e shikonte botën nga premisa e ekzistencës së Zotit. Për Zhjin, Zoti ekzistonte. Ishte besimtar dhe e ndante këtë lloj dimension në formulimet e pikëpamjeve apo mendimeve të veta, në gjërat që fliste apo shkruante.

Ajo që ka thënë Zheji, ajo që ka shkruar, apo që ka lënë si trashëgimi mediatike, publicistike, apo gjithfarësoj në shtypin shqiptar, përvijohet nga këto tre elemente: Të qenit njeri që mbron fort lirinë; patriot, prani njeri që e lidhte, e orientonte shumë mendimin e vet nga çështja e kombit; Të qenit besimtar i devotshëm, në sensin e besimit të plotë, përtej praktikave fetare që është diçka tjetër. Ishte një besimtar i devotshëm i krishterë dhe kishte respekt të thellë për besimet e tjera. E kishte thënë shpesh se kishte lindur nga një baba i besimit ortodoks dhe një nënë e besimit mysliman, pasi ajo ishte nga Kosova. Pra, kjo lloj gjeografie kishte ndikuar. Dihej që influenza e të atit ishte shumë e madhe për shkak edhe të asaj që ai përfaqësonte si një personali i madh i dijes shqiptare.

Vijoj ta kem edhe sot në mendjen time atë që përfaqësonte dhe ishte Zheji: një njeri babaxhan, prani e madhe në vendin e punës, një piketë udhërrëfyese për pikëpamjet politike që ndiqte MAPO. Në kuptimin e njohjes personale dhe asaj që përfaqësonte, ai ishte një njeri shumë interesant, me të cilin mund të rrije gjatë, të pije kafe gjatë, të flisje gjatë. Një njeri me bonsens të habitshëm. Shoqëria jonë është e teje mbushur me njerëz që nuk kanë bonsens, që kanë inate, kanë sjellje arrogante apo të çuditshme në vendin e punës.

Ai nuk ishte asnjë gjë nga këto. Ishte një lloj mini-shenjtori, i vogël në shumë aspekte, siç ishte një lloj boehmi në aspekte të tjera. Do ta kujtoj gjithmonë si personin që bënte bashkë njeriun babaxhan, bohemin dhe njeriun popullor. Në aspektin intelektual kishte tre pikat e tjera të forta: patriotizmin, besimin dhe liberalizmin.

Mendoj se kjo është gjëja më e madhe që solli. E ka lënë me këmbëngulje në çdo shkrim, ku shfaqë më së miri dimensionet e tij. Mbjaj mend mbledhjet në redaksi, kur debatonin gazetarët dhe Zheji mbante një qën-

drim të shpenguar. Ai reagon vetëm kur ndodhte diçka interesante dhe duhet të ndërhynte për të thënë mendimin e vet. Kishte një këndvështrim që bëhej imponues.

20 vjetori e rikthen MAPO-n me risi

Brahim Shima, kryeredaktor i MAPO

MAPO e 20 viteve më parë u krijua me kontributin e emrave më të njohur. Jo vetëm gazetarë, politikanë dhe ekspertë iu bashkuan këtij rrugëtimi që solli një media ndryshe nga ajo që ishte më parë. Solli një pakt të fortë intelektual në kohën e krijimit, me analiza të thelluara dhe trajtim ndryshe të lajmit.

Një ndër figurat e rëndësishme kontributore në këtë media ishte edhe Zheji. Unë e shikoja në atë kohë si "kundërshtar", sepse solli ide dhe frymë të re në një media shqiptare duke sfiduar traditën. Zheji krijoi impakt të madh në jetën sociale dhe në organizimin politik të vendit.

Sot media ka ndryshuar. Nuk është më media ku shfaqeshin debatet, reportazhet, teksti i gjatë, materialet e plota. Teknologjia ka bërë të vetën. MAPO hyn në

vitin e 20 të themelit të saj. Me ndryshimin dhe evolucionin e gjërave asaj i lind detyrimi që të përshtatet. Për mua si kryeredaktor është një mision i vështirë ta mbaj një media avangardë, duke pasur parasysh trashëgiminë që e shoqëron.

Sot kanë marrë hov mediat online dhe duket sikur printi nuk lexohet më. Mendoj se printit nuk i ka ikur koha, njerëzit e duan, por forma si serviret është e gabuar. Prandaj MAPO ka vendosur që të kthehet me ndërthurjen e të dyja varianteve.


Ndryshe nga mediat e tjera ekzistuese, MAPO do të ruajë traditën e printit. Jo atë të përditshëm, por do të jetë një herë në muaj me botimin e Revistës MAPO. Do të paraqesë gjithçka që ndodh në vendin tonë, por nuk do të mbetet te materiali i thjeshtë, i papërpunuar. Do të shkojë më tej. Do të paraqesë opinione, këndvështrime, reportazhe, analiza, gjëra që mungojnë në mediat e sotme. Aty do jenë analizat e emrave më të njohur në Shqipëri, ekspertiza, reportazhe, etj.

Revista MAPO do të jetë e organizuar në disa nënndarje e kategori ku gjithsecili do të gjejë veten. Do të ketë MAPO Universitet (Universitas), një hapësirë për studentin, për t'u frymëzuar dhe për të ecur më tej. Do të vijë Madamë MAPO, në qendër të së cilës do të jetë gruaja shqiptare në zhvillim dhe në karrierë.

Do të kemi MAPO Debat, ku do të përballen mendimet e emrave të njohur, të cilët do të sjellin këndvështrime të gjera mbi atë se çfarë ndodh aktualisht në Shqipëri në të gjitha nivelet dhe cilat janë pasojat e këtyre vendimmarrjeve në të ardhmen. Do të kemi MAPO Teknologji, e pasqyruar përmes zërit të ekspertëve të fushës, që do të diktojnë zhvillimet e fundit, të dhëna konkrete dhe analiza mbi efektet e këtyre zhvillimeve teknologjike.

MAPO online, nga ana tjetër, do të jetë më e gjerë dhe më e plotë në informacion. Do të sjellë lajmet e përditshme, zhvillimet e shpejta, por do të ketë edhe thellime, këndvështrime të ndryshme, ekspertiza të plota ekonomike, sociale, për t'u pasqyruar më tej në të gjitha kanalet dhe mjetet e reja të komunikimit. Vendi i saj do të kenë edhe pjesa e printit, tashmë duke përpunuar dhe duke sjellë të përmbledhura dhe në formën e përshtatshme të gjitha rubrikat e revistës.

Jo vetëm kaq, MAPO do të sjellë risi të tjera. Do të kemi podkastin tonë, i cili do të ndahet në kategori të ndryshme. Debati politik nuk do të mungojë, por do t'i shtohet debati ekonomik, social, debati mbi një sërë zhvillimesh dhe reformash në Shqipëri. Në podkast do të trajtojmë tema që shqetësojnë shoqërinë shqiptare, pika që i mungojnë medias sot në Shqipëri.



MAPO – HISTORIA E NJË MARKE

MAPO është historia e një vizioni që nuk u dorëzua. Nga letra te ekrani, nga fjala e shtypur te podcast-i, ajo mbetet një shenjë e përpjekjes për ta mbajtur fjalën e lirë gjallë – në çdo epokë të rrugëtimit të saj mediatik.

Revista që sfidoi rutinën (2006–2010)

Editoriali “Mirë se vini në MAPO!” shënonte hyrjen e një reviste të re në tregun mediatik shqiptar në tetor të vitit 2006, me një frymë sfiduese ndaj klimës gri dhe uniformitetit që karakterizonte shtypin e kohës. Themeluesit e saj e shihnin “MAPO”-n si një projekt guximtar e novator; të ndërtuar mbi profesionalizëm, integritet dhe dëshirën për të vendosur standarde të reja në gazetarinë periodike.

Emri “MAPO” mbartte simbolikën e një provokimi të vetëdijshëm – një lojë ironike me kujtesën e së shkuarës, ku “Magazina

Popullore” e dikurshme transformohej në një “magazinë idesh” për shoqërinë moderne shqiptare.

Me në krye Skënder Minxhozin, dhe me bashkëpunëtorë si Ben Andoni, Lorenc Vangjeli, Erl Murati e Ervin Qafmolla, “MAPO” solli një format të ri – një revistë javore me shpirtin e një gazete të përditshme, që thellohej në tema politike, sociale, kulturore e ekonomike.

Skënder Minxhozi, drejtori i parë i revistës “MAPO” në vitin 2006, e përshkruan nisjen e saj si një aventurë të pasionuar dhe idealiste, në një kohë kur shumë projekte mediatike lindnin me ëndrrën për të ribërë standardet e shtypit shqiptar. Edhe pse financiarisht mbeti një sipërmarrje e brishtë, “MAPO” u bë shpejt një media referuese për analizat, investigimet dhe debatet publike, e njohur për guximin editorial dhe profesionalizmin e saj.

Pas vitit 2010, revista u shkri natyrshëm me projektin e ri të Henri Çilit, që e ktheu “MAPO”-n në një gazetë të përditshme, duke i dhënë emrit një jetë të re. Megjithë sfidat e medias tradicionale dhe ngritjen e portaleve online, “MAPO” mbetet një simbol i idealizmit gazetaresk dhe i përpjekjes për të mbajtur gjallë gazetarinë e thellë, të ndershme dhe me dinjitet profesional në Shqipëri.


MAPO e Përditshme (2010)

Më 5 korrik 2010, “Gazeta MAPO” doli në treg me formatin e saj elegant berliner dhe me një faqe të parë që shënonte ambicien e saj për të qenë gazetë serioze dhe me vizion:

“SHBA, ndryshim kursi në Tiranë”

Ajo nuk ishte as gazeta e parë e as e fundit që hynte në treg me një qëndrim të qartë editorial, por gjatë gjithë rrugëtimit të saj në shtypin shqiptar, nën drejtimin dhe pronësinë e Henri Çilit, “MAPO” mbeti një gazetë profesionale, një hapësirë e lirisë intelektuale dhe e debatit qytetar, që i qëndroi besnike standarde të gazetarisë së ndershme dhe analizës me vlerë.

Në editorialin e tij të parë botuesi Henri Çili argumentonte se



Drejtor i Mapo: Henri Çeli
Çështjet e ditës: 10.000
Koha: 10.000
Koha: 10.000
Çështjet e ditës: 10.000

GAZETA MAPO



Trafik i makinave
Skema e re e gjurmimit nga policia **FAQE 7**

AMBASADORI I RI

SHBA, NDRYSHIM KURSI NE TIRANE

Përzgjedhja më e fundit e Obamës ka ngritur një sërë pikëpyetje në dy kampet politike. Alexander A. Arvizu, ekspert për Çështjet e Azisë, pritjet të jetë larg shfaqjes së preferencave politike. **FAQE 2-3**



Pagat dhe buxheti, plani i Bodes pret FMN

Financat kanë gati disa skenarë për ndryshimet në buxhet dhe rritjen e pagave. Në cilin do të konsultohen me ekspertët e FMN



Henri Çeli
Pse "MAPO" pse edhe gazetë psetani?
Nga sot, e hënë, 5 korrik 2010, do të publikojmë për herë të parë shprehjet e opinionit të gazetës "MAPO" në lidhje me buxhetin dhe rritjen e pagave të funksionarëve të shtetit. Këtë gjë ne e bëjmë për të treguar se gazetë e pavarur dhe e përditshme mund të jetë një alternativë e re për funksionarët e shtetit dhe për qytetarët.

KARIKATURA



MOTI

17°C
18°C
19°C
20°C

KURSI

136.7

"Mapo", redaksia e një dite më parë



18 Në kërkim të fotove të 2 korrikut

Kalvari për gjetjen e tyre

Shijoni pushimet tuaja në Kompleksin "KEVIN"

Adresa: Kompleksi "Kevin", 4 kullat, pranë lapidarit, Shëngjin.

KOMENTE II

Përse Hayek-u përriktet persëri në skenë?
Kësaj qështjeje themelimit të gazetës "MAPO" në korrikun e vitit 2010, ai ishte duke biseduar për rikthimin e tij në tetor si drejtor i mediave Mapo – pothuajse kishte arritur marrëveshjen.

një pikë reference, në një kohë kur shpejtësia po e zëvendëson të përmbajtjen.

Vite më vonë, në dhjetëvjetorin e themelimit të gazetës ish-ambasadori Alexander Arvizu, metë cilin ishte çelur numri parë i MAPO-s si e përditshme do të shprehej për të: "Kur jetoja në Tiranë, MAPO ishte një 'duhet lexuar' për mua çdo ditë dhe, që nga kthimi në Uashington kam përvuar t'i ndjek zhvillimet në Shqipëri përmes Mapo online.

Çdo gazetë, qoftë në Shqipëri apo Amerikë, ka stilin e vet të të raportuarit dhe orientimin editorial, dhe MAPO, natyrisht, nuk bën përjashtim. Por, një gjë që ia kam vlerësuar MAPO-s përgjatë viteve është busulla e saj e qartë dhe të kuptuarit se një e ardhme pozitive, zhvilluese për popullin shqiptar, do të vijë vetëm nëpërmjet integritimit më të thellë me pjesën tjetër të Europës dhe me Perëndimin më gjerësisht. Posaçërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës"

Veliera kundër kohës (2011-2015)

"Në krye të 'velierës MAPO' u ngjit Artur Zheji – një zë cinik, filozofik dhe sfidues. Ai e quajti gazetën 'një anije kundër kohës', në një epokë ku gjithçka po bëhej virtuale."

Zheji. Në një editorial të vitit 2014 për Gazetën Mapo, në një kohë kur epoka digjitale kishte nisur ta kërcënonte fort shtypin klasik, ai shkruante:

"Një aventurë e pamundur? Një anije kundër kohës?! Ndoshta po, ndoshta jo. Ndoshta mendojmë, me ose pa të drejtë, se e veçanta jonë qëndron pikërisht në këtë raport të përmbysur me kohën. Në të drejtën për të ekzistuar edhe në letër, edhe në silic. Në besimin, sado shpresëpakët, se libri dhe gazeta klasike, sidoqoftë, nuk do të vdesin. Sepse një rrymë ithtarësh të asaj që ishte gazeta, një aleancë mendjesh të paqeta, që grupohen në të njëjtën 'Agora', ndoshta do të kenë gjithmonë nevojë të gjejnë tek ne shtëpinë e tyre të hapur. Shtëpinë ku ka gjithmonë një zjarr të ndezur dhe një laborator idesh."

Në mbledhjet periodike në redaksinë e Mapo-s, i ulur në tavolinën e madhe prej druri arde, ai ishte gjithnjë figurë qendrore. Jo vetëm për rolin e tij si drejtor i gazetës, por për aftësinë që kishte t'ua kujtonte gazetarëve – edhe në kohë sfiduese për profesionin dhe të vërtetën – rëndësinë e misionit të tyre. Ashtu siç ua përsëriste shpesh me shaka, por me një të vërtetë të madhe brenda atyre fjalëve: "Dhjetë vite punë në gazetari të shkurtoj në jetën."

Ironik, por gjithmonë i thellë, Artur Zheji jepte ndjesinë e një figure publike të plotë – me përmasë, autoritet dhe ndikim në jetën intelektuale shqiptare.

Zheji iu bashkua Mapo-s fillimisht pas vitit 2011 dhe më pas sërish në vitin 2015, edhe pse nuk arriti të rikthehej më në vitin 2025. Në qershor të atij viti, ai ishte duke biseduar për rikthimin e tij në tetor si drejtor i mediave Mapo – pothuajse kishte arritur marrëveshjen.

vazhdimi i titullit ekzistues, në vend të krijimit të një emri të ri, ishte një zgjedhje e qëllimshme për t'i dhënë qëndrueshmëri dhe vazhdimësi historisë së shtypit të shkruar në Shqipëri, i cili pas çdo epoke politike kishte humbur titujt e tij më përfaqësues.

Gazeta iu besua Arion Sulos – një gazetar me përvojë të gjatë në disa prej redaksive më të rëndësishme të vendit. Ai kishte drejtuar Gazetën Shekulli dhe më herët kishte dhënë kontributin e tij si kryeredaktor në Gazetën Korrieri, dy institucione të mëdha të shtypit shqiptar, që kishin ndërtuar kulturën e gazetarisë së pavarur pas viteve '90.

Gazeta nisi si një e përditshme informativo-analitike, me qëndrim të qarta editoriale dhe me synimin për të dekurruar realitetin politik e shoqëror. Në një botë ku çdo ngjarje bëhet lajm brenda pak minutash, MAPO kërkoi të qëndronte më thellë – tek interpretimi, tek analiza, tek "pse"-të e ngjarjeve.

Editorialet e saj mbanin firmat e disa prej analistëve më të mirë të vendit, ndërsa Sulo vendosi një standard të ri në raportin mes informacionit dhe opinionit. Edhe në formë, gazeta komunikonte ndryshe: me fotografinë e madhe të faqes së parë dhe karikaturën e Kapexhiut, që çdo ditë qarkullonin përtej tirazhit të saj në mediat vizive dhe rrjetet online.

Çdo të shtunë, MAPO vinte me një edicion special – një agora idesh, ku debati, reflektimi dhe analiza e thellë ishin pjesë e përjavshme e identitetit të saj. Ishte mënyra e gazetës për të mbetur

MAPO në kohën e krizës së shtypit (2015–2020)

Dikur me formatin e gjatë berliner, MAPO binte në sy për elegancën vizuale dhe për qëndrimin editorial të paparashikueshëm, një tipar që e bënte të veçantë në panoramën mediatike shqiptare. Në këtë rrugëtim, Alfred Lela mori drejtimin e Gazetës MAPO, pasi më herët kishte shërbyer si zëvendëskryeredaktor i saj dhe kryeredaktor i revistës së përmuajshme MAPO – një botim që i kushtojë protagonistëve dhe ngjarjeve më të rëndësishme që përkufizonin çdo muaj. Kjo përvojë e afërt me jetën editoriale e ndihmoi të ruante frymën analitike, debatin intelektual dhe standardin estetik që gjithmonë e ka karakterizuar këtë markë.

Përtej një gazete, MAPO u shndërrua në një logo kulturore dhe komunikimi publik, nën të cilën bashkëjetuan revista si MAPO dhe Madame MAPO, platforma digjitale mapo.al, shtëpia botuese MAPO Editions. Kjo bëri MAPO-n më shumë se një medium – një ekosistem idesh, imazhi dhe kulture.

Pas Lelës, drejtimin e Gazetës MAPO do ta merrte Ervis Iljazaj. Edhe pse Iljazaj nuk vinte nga bota klasike e gazetarisë, formimi i tij në shkencat politike në Itali, bashkë me karrierën akademike si pedagog në universitet dhe kontributin si zë i ri në analizën politike shqiptare, e bënë një figurë të përshtatshme për të udhëhequr redaksinë në një fazë të re. Në drejtimin e tij, MAPO ruajti frymën analitike dhe seriozitetin intelektual, duke e forcuar profilin e vet si një hapësirë debati, reflektimi dhe qëndrimi kritik ndaj realitetit politik e shoqëror.

Në editorialin e tij për 10-vjetorin e gazetës më 2016, kryeredaktori Arion Sulo do ta quante këtë rrugëtim “aventura e një gazete në kohën e internetit”. Një aventurë që nisi në një periudhë të vështirë, kur gazetatat në të gjithë botën po përballeshin me rënien e shitjeve dhe zhvendosjen e lexuesit drejt botës online. “Përshtatuni ose vdisni”, – do të ishte dilema e kohës, thoshte ai, – por MAPO zgjodhi të përshtatej pa humbur shpirtin e vet.

Nën drejtimin e Çilit, gazeta ruajti standardin profesional dhe



Kapexhiu, Zheji, Çili, në promovimin e ekspozitës së mediave Mapo

karakterin qytetar, duke kaluar nëpër disa etapa zhvillimi, përfshirë riformatimin si “Gazeta Liberale”, me synimin për ta mbajtur gjallë një titull me peshë në jetën publike. Ai e konsideronte median shqiptare si një nga tre shtyllat themelore të tranzicionit, bashkë me politikën dhe ekonominë, dhe ndiente krenari që kishte kontribuar në formësimin e këtij kapitulli të rëndësishëm të shoqërisë moderne shqiptare.

MAPO 2025 – Epoka e re

Rikthimi i MAPO-s në vitin 2025 shënon një etapë të re në historinë e saj mediatike, një shkrirje natyrshme me Gazetën Liberale dhe portalin ekzistues, për t’u konsoliduar si një gazetë elektronike bashkëkohore, pa e braktisur identitetin e vet tradicional.

Në këtë fazë, MAPO rikthehet si një platformë e integruar mediatike, që bashkon shkrimin analitik me formatet vizuale dhe multimediale të kohës, duke u pozicionuar në kufirin mes traditës dhe inovacionit.

Ashtu siç kishte parashikuar botuesi i saj në editorialin e parë të 5 korrikut 2010, “media e shkruar shumë shpejt do të ketë statusin e operës”, sot, 15 vite më vonë, kjo profeci është bërë realitet: gazetatat kanë mbetur një fenomen elitare, nostalgjik, por thelbësor për kulturën e komunikimit.

Për ta ruajtur këtë frymë, MAPO do të vazhdojë të botohet edhe në format mujor në letër, si një kujtesë estetike e gazetarisë klasike. Krahas versionit të përditshëm online, ajo do të përfshijë podkaste, videodokumentarë dhe rubrika të specializuara, duke luftuar në tre fronte që e përkufizojnë gazetarinë e re: Script – Foto – Print. Synimi mbetet i pandryshuar — jo sasia, por cilësia, jo thjesht informimi, por kuptimi i botës ku jetojmë.

Drejtimi i Gazetës MAPO në këtë epokë të re është në duart Preç Zogaj, një nga figurat më të njohura të shtypit dhe mendimit publik shqiptar pas viteve ‘90. I lidhur ngushtë me historinë e pluralizmit, Zogaj është ndër emrat themelues të gazetarisë së lirë në Shqipëri, si drejtori i parë i “Rilindjes Demokratike”, gazeta simbol e ndryshimit demokratik, e cila në dhjetor të vitit 1991 u bë zëri i parë i epokës së re politike. Ai ka qenë më pas themelues dhe drejtues i gazetës “Aleanca” apo “Dita”, si dhe një prej publicistëve më të ndjeshëm e reflektues të tranzicionit shqiptar, me kontribute të spikatura edhe si shkrimtar, poet dhe autor i publicistikës mbi periudhën dhe ngjarjet politike të këtyre dekadave.

Me ardhjen e tij si drejtor i MAPO-s, gazeta hyn në një fazë të re, ku përvoja dhe reflektimi historik ndërthuren me sfidat e kohës digjitale. Zogaj pritet ta udhëheqë këtë platformë mediatike në përballjen me realitetin e epokës së inteligjencës artificiale dhe teknologjisë së informacionit, duke ruajtur thelbin e saj: një gazetë me frymë demokratike e liberale, me theks të fortë kulturor dhe intelektual, që synon të pasqyrojë dhe interpretojë zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, ato që meritojnë të debatohen dhe të bëhen pjesë e hapësirës publike.



SUPLEMENT
PËR ARSIMIN
E LARTË

UNIVERSITAS

TCT
Si lind një kolegji
teknologjie

ANGJELOS LAMÇAJ
Ekselenti i Diplomës
Profesionale në TCT

LAERT DURAJ

KPT- TCT, lëvizja drejt së ardhmes

Dhjetë vjet më parë vendosi të hapë një kolegji profesional, duke shndërruar ëndrrën e tij në realitet. Themeluesi Laert Duraj tregon sfidat, momentet e pasigurisë dhe gëzimin që vjen kur një vizion bëhet i prekshëm dhe ndihmon të rinjtë të ndërtojnë të ardhmen e tyre.



TIRANA COLEGE OF TECHNOLOGY

Si lind një kolegji teknologjie

Me katër programe bachelor dhe 8 profesionale, staf të shtuar, standarde dhe ambicie të reja.

Tirana College of Technology nis rrugëtimin e dekadës së dytë, mbi një trashëgimi të qëndrueshme si IAL i parë në Shqipëri që iu dedikua plotësisht Diplomave Profesionale.

Një dekadë pas hapjes së dyerve, Kolegji Profesional i Tiranës ka hedhur një hap të rëndësishëm për të ardhmen e këtij institucioni të arsimit të lartë në Shqipëri. Me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe

Sportit është vendosur riorganizimi i Kolegjit të Lartë Profesional në Kolegj Universitar, i cili do të mbajë emrin Tirana College of Technology (TCT).

Urdhri Nr.266, i datës 19 qershor 2025, iu është dërguar institucioneve përkatëse për njohjen e institucionit

më të ri të arsimit të lartë shqiptar, i cili vjen me një ofertë të pasuruar akademike për të gjithë studentët që duan të formohen në drejtim të inxhinierive kompjuterike dhe industriale.

Kalimi në kolegji universitar vjen në kushtet kur KPT është në konsolidimin e një dekade veprimtarie në fushën e arsimit të lartë profesional në vendin tonë, me përvojë dhe rrjetëzim në projekte të ndryshme ndërkom-bëtare, me kapacitete të bollshme burimore në dispozicion, më një infrastrukturë moderne, pra në kohën e duhur për të zgjeruar dhe përmirësuar ofertën akademike aktuale, edhe me programe bachelor.

“TCT nuk po ndërtohet nga zero, por mbi bazën e KPT-së. Ka një bazë të fortë, e cila është siguri për kalimin në një hap më të lartë të formimit profesional, siç janë diplomat Bachelor”, shprehet rektori Prof. Dr. Ing. Andonaj Lamani.

Me riorganizimin në kolegji universitar, Tirana College of Technology do të përbëhet nga dy fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Industriale dhe Civile. Fakulteti i Inxhinierisë Komp-

juterike ka në organigramën e vet dy departamente dhe një qendër kërkimi: Departamenti i Informatikës së Aplikuar; Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; Qendra për Kërkim, Inovacion dhe Zhvillim në Teknologji Informacioni.

E njëjta strukturë do të jetë edhe për fakultetin tjetër, atë të Inxhinierisë Industriale dhe Civile, i cili do të ketë Departamentin e Inxhinierisë Civile, Departamentin e Inxhinierisë Industriale dhe Qendrën për Kërkim, Inovacion dhe Zhvillim në Inxhinieri Industriale dhe Civile.

Pse TCT dhe pse tani?

Sot po jetohej në një epokë të jashtëzakonshme të inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, një periudhë që ka përfshirë në mënyrë thelbësore çdo aspekt të jetës, jo vetëm atë të prodhimit dhe të krijimit, por ka ridimensionuar mënyrën e të menduarit dhe të jetuarit. Në epokën e Industrisë 4.0, digjitalizimi është bërë gur themeli i konkurrueshmërisë dhe efikasitetit në ndërmarrjet industriale, e për rrjedhojë edhe teknologjitë janë bërë digjitale. Tashmë prodhimi tradicional po kombino-





het me teknologjitë digjitale, duke sjellë efikasitet të lartë në prodhueshmëri, optimizimin e plotë përmes AI, kryerjen e proceseve të komplikuar përmes robotikës etj.

Në këtë peizazh global që ndryshon dita ditës, askush nuk e ka luksin për të qëndruar indiferent. Përshtatja dhe integrimi nuk është thjesht një zgjedhje, është domosdoshmëri.

Me gjithë përmirësimet, Shqipëria renditet ulët në treguesit e inovacionit siç është Indeksi Global i Inovacionit. Raporti i këtij indeksi për vitin 2024 e vë Shqipërinë në vendin e 84 ndër 133 ekonomitë e përfshira në studim. Kjo do të thotë, se përvetësimi i këtyre teknologjive dhe strategjive të reja është i domosdoshëm

për të rritur qëndrueshmërinë dhe për të përparuar drejt një të ardhmeje industriale më inovative dhe të fuqishme. Në këtë kuptim, përveç mbështetjes së qeverisë dhe organeve të tjera zyrtare apo të industrisë, një rol të rëndësishëm kanë universitetet në formimin e kapaciteteve intelektuale e njerëzore që ndërtojnë mendësinë e re dhe përvetësojnë njohuritë e nevojshme për të jetuar në Industria 4.0.

Hapja e 4 programeve bachelor në TCT, me fokus kryesor teknologjitë e reja, sjell shumë avantazhe dhe rrit potencialin për zhvillim të vazhdueshëm në këtë fushë të rëndësishme për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare. Ky është një hap pozitiv drejt modernizimit, rritjes së cilësisë dhe përmirësimit të sistemit arsimor në vend.

Theksi kryesor i programeve është aplikimi i njohurive shkencore në zgjidhjen e problemeve reale, çka sjell inovacion dhe adreson sfida praktike në industri të ndryshme dhe për më tepër adreson një nevojë reale që ka tregu i punës dhe dinamika e tij për një forcë pune të aftë dhe profesioniste.

Janë 4 programe të reja 3-vjeçare të licencuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në disa prej fushave më të rëndësishme të tregut të sotëm global, i cili po jeton në Revolucionin e Katërt Industrial, apo siç njihet ndryshe Industria 4.0. Programet e reja: Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Civile, Inxhinieri Elektronike dhe Inxhinieri Software, do t'iu krijojnë mundësinë të rinjve shqiptarë që të gjejnë vendin e tyre në tregun e punës, një treg që ndryshon me shpejtësi dhe orientohet nga teknologjitë në zhvillim

“Sfida jonë e përbashkët si Tirana College of Technology është të punojmë së bashku që teknologjia të bëhet një forcë pozitive dhe transformuese në jetën tonë, në ekonominë dhe zhvillimin e vendit. Është privilegj për mua të jem pjesë e një ekipi që buron nga bota akademike dhe që është i lidhur ngushtësisht me teknologjinë dhe risitë që ajo ka sjellë ndër vite në vendin tonë”, shprehet prof. Lamani.

Përveç Diplomave Profesionale dhe Dipolmave Bachelor, Tirana College of Technology synon të ofrojë edhe cikle studimi më të shkurtra dhe kurse të specilizuara 1-vjeçare ose disa mujorshe, në disa prej fushave që kërkojnë profesionistë me njohuri bazë në sektorin ku operojnë.

Bilanci i një dekade KPT

Ky rrugëtim i ri i Tirana College of Technology ndërtohet mbi bazat e forta të hedhura prej një dekade nga Kolegji Profesional i Tiranës, i cili i ka ofruar arsimin të lartë disa prej programeve 2-vjeçare më të kërkuara në

tregun e punës. Kur nisi rrugëtimin më 2015-ën, kolegji ishte risi për terrenin shqiptar, duke përmbushur nevojën për zbatues dhe teknikë të lartë.

“Që në krye të herës ne u morëm me programet e studimit dhe kurrikulat e lëndëve, që të ishin në nivelin e duhur, qoftë në nivelin teorik qoftë në nivelin praktik. Ia nënshtruar gjykimin specialistëve të fushës, por morën pjesë edhe nga biznesi, duke marrë parasysh edhe kërkesat e tyre në hartimin e kurrikulave”, tregon rektori i parë i dekadës së parë të KPT-së, Prof. Dr. Lu-an Karçanaj.


Në 10 vite, Kolegji Profesional i Tiranës ka regjistruar 1514 studentë dhe ka diplomuar 1120, në dhjetë programet e studimit: Elektronikë; Database dhe Web Design; Teknologji e Instalimeve elektrike; Administrim Zyre; Elektro-mekanikë; Teknologji Automjetesh; Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi; Gjeodezi; Teknologji Ndërtimi. Këta të diplomuar kanë zënë tashmë vendin e tyre në tregun e punës, si profesionistë dhe asete të çmuara për ekonominë dhe vendin tonë. Pavarësisht, se kolegji nuk ka kriter regjistrimi mesataren, ndër vite ai ka pasur mjaft studentë të mirë me mesatare mbi 8-të nga gjimnazi.

KPT regjistron mjaft rekorde pozitive në dekadën e tij të parë, sa i përket stafit akademik, partneriteve dhe bashkëpunimit me industrinë. Ai është dalluar për kombinimin e gjeneratave të ndryshme në mësimdhënie, atyre me shumë përvojë, që sjellin njohuritë dhe metodologjinë klasike, e domosdoshme për programe specifike, me pedagogët e specialistët e rinj që sjellin praktikën më të reja nga industritë dhe tregu i punës. Gjatë këtyre viteve, KPT ka pasur 160 persona staf akademik, disa prej të cilëve me një përvojë të gjatë dhe me gradat më të larta shkencore.

Ka bashkëpunuar me mbi 100 biznese, kompani, industri të ndryshme në Shqipëri, të cilat vijojnë të japin kontributin për kurrikulat mësimore për përgatitjen e specialistëve që iu duhen në stafet e tyre, por edhe ofrojnë praktikën e më tej punësim për shumë prej studentëve të kolegjit.

Po ashtu, KPT nuk ka lënë pas procesin e ndërkombëtarizimit, duke u bërë pjesë e projekteve dhe partneriteve ndërkombëtare, përveç marrëveshjeve me institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Gjatë viteve ka fituar 15 projekte, të cilat i kanë sjellë një përvojë të çmuar stafit akademik e administrativ, por edhe e kanë ekspozuar këtë kolegji ndaj eksperiencave më të mira ndërkombëtare, duke dhënë edhe ai kontributin e vet në aspekte të caktuara.

“Me përfshirjen në projektet europiane, filloi një punë



mjaft e madhe dhe falë dedikimit të stafit u arritën përmirësime në disa drejtime. Më së pari është përmirësimi i kurrikulës. Duke ndarë përvojën tënde me ato të universiteteve në rajon dhe në vendet e BE-së, përmirëson kurrikulën tënde, lëndët ekzistuese dhe duke sjellë të reja, sidomos kur këto lëndë orientohen nga tregu i punës dhe mbështeten në laboratorët”, shprehet administratorja e TCT, Diana Biba.

Krahas projekteve madhore kombëtare ndërkombëtare, kolegji dhe studentët e tij kanë ndërtuar 11 projekte në KPT HUB, Laboratorin e Inovacionit që funksionon prej vitesh në këtë institucion dhe shërben për aftësimin praktik të studentëve që në auditor.



CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

CEREMONIA E DIPLOMIT 2025

LAERT DURAJ

KPT- TCT, lëvizja drejt së ardhmes

Dhjetë vjet më parë vendosi të hapë një kolegji profesional, duke shndërruar ëndrrën e tij në realitet. Themeluesi Laert Duraj tregon sfidat, momentet e pasigurisë dhe gëzimin që vjen kur një vizion bëhet i prekshëm dhe ndihmon të rinjtë të ndërtojnë të ardhmen e tyre.

Nga themelues i një universiteti privat te ngritja e një kolegji profesional, si ishin fillimet e Kolegjit Profesional të Tiranës?

Ashtu si tek Universiteti European i Tiranës, edhe tek kolegji kam preferuar gjithmonë të punoj në skuadër. Janë sfida të një natyre të veçantë që mbulojnë shumë fusha dhe, duke qenë se ishte një aktivitet i ri, patjetër që bashkimi i forcave e bën më të mundur rritjen e përqindjes së suksesit.

Këto fusha lidhen me menaxhimin, pjesën akademike, laboratorët... Pra, duhej një skuadër e fokusuar në sektorë të ndryshëm për të arritur rezultatet më të mira.

Sigurisht, për shkak të përvojës sime në UET, si themelues i tij dhe si personi që kaloi pothuajse çdo hallkë – që nga dokumenti i parë deri te përfundimi i operacionit të blerjes së godinës së dytë – e kisha më të lehtë të merrja drejtimin e kësaj skuadre.

Në fakt, skuadra përbëhej nga unë, Rudi, Diana, Korabi, Klara dhe Hyseni – ky i fundit edhe një nga pronarët e godinës, i cili na e lehtësoi procesin dhe vendosi të kontribuonte në krijimin dhe rritjen e kolegjit.

Në treg kishte një lloj “urie” për këtë profesion. Për të thënë të drejtën, tani që kanë kaluar 10 vite, mendoj se kërkesa nuk ishte aq e madhe sa e prisnim. Mendonim

se do të kishte më shumë interes nga të rinjtë, sidomos pasi për sistemin 3-vjeçar bachelor u vendos si kusht nota mesatare.

Megjithatë, ajo që më bën të ndihem krenar është fakti se të gjithë atyre që u diplomuan me sistemin tonë 2-vjeçar u ka ndryshuar në mënyrë thelbësore jeta. Dhe jo vetëm në aspektin e të ardhurave – pasi të punosh në sektorin e shërbimeve me dije të konsoliduara të jep një avantazh – por edhe sepse puna është e garantuar, jo vetëm në tregun shqiptar, por edhe jashtë Shqipërisë.

Këta studentë kanë paga të larta, siguri punësimi dhe janë të kërkuar gjithnjë e më shumë. Jam i bindur që me këto dije mund të punojnë pa asnjë problem edhe në tregun european, i cili është shumë më kërkuar se ai shqiptar.

Kolegji Profesional i Tiranës hapi dyert më 2015-ën, fill pas ndryshimeve në ligjin e arsimit të lartë, që krijonte hapësirë për diplomat profesionale. Cilin ishin sfidat e para, duke qenë se ky lloj arsimit ka specifikat e veta dhe ju ishit institucioni i parë i profilizuar?

Ajo që më nxiti më tepër ishte qasja dhe vizioni i qeverisë dhe i forcës sime politike, tek e cila kisha besim.



E dija se e kishin shumë seriozisht qasjen ndaj arsimit profesional. Që në fillim u tha me zë të lartë se arsimit profesional do të ishte një nga prioritetet e qeverisë, me bindjen se më pas do t'i shërbente edhe plotësisht të nevojave të një vendi në zhvillim.

Kjo ishte lehtësuese, pasi deri në atë moment – para 10 viteve – ligji i arsimit të lartë dhe kontrolli rigoroz mbi institucionet private ishin në kulmin e tyre. Nuk ishte klima e duhur për të hapur një institucion të ri. Por falë kësaj qasjeje pozitive ndaj arsimit profesional, gjetëm një ambient miqësor, edhe pse të rreptë, për të na ndihmuar të plotësonim standardet.

Dy persona nuk do t'i harroj kurrë: Linda, drejtoresha e Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit, dhe Taku, të cilët me rigorozitet për t'u admiruar monitoruan e ndoqën hap pas hapi çdo fazë të aplikimit për hapjen e kolegjit.

Kjo ishte sfida jonë më e madhe: ishte hera e parë në Shqipëri që një institucion i arsimit të lartë hapej në formën e një kolegji profesional. Ishte një hap pionier. Por falë një grupi të mirë me të cilin e nisa këtë rrugëtim dhe qasjes pozitive që kishte qeveria, u bë e mundur hapja e këtij kolegji.

Ne kishim dëshirë që nga fillimi ta bënim sa më mirë. Një nga sfidat kryesore ishin laboratorët. Pamë gjithandej dhe kompania që na u duk më e përshtatshme për të na ndihmuar ishte një kompani greke e quajtur Politech.

E përmend këtë, pasi një nga përfaqësuesit e kësaj kompanie, inxhinieri Niko – të cilin e vlerësoj shumë – ishte pranë nesh hap pas hapi, për të na ndihmuar në instalimin e çdo laboratorit, përshtatjen e laboratorëve me kurrikulat tona dhe për të na këshilluar që t'i bënim sa më efikasë për nevojat e tregut. Duke qenë se ishim të parët, nuk e njihnim aq mirë këtë fushë.

Edhe sot vazhdojmë bashkëpunimin me këtë kompani dhe laboratorët tanë janë ndër më të mirët në Shqipëri. Madje profesorë të nderuar nga universitetet shtetërore kanë shprehur admirimin e tyre, duke thënë se laboratorët e kolegjit tonë janë edhe më të mirë se disa prej laboratorëve të inxhinierisë në Universitetin Shtetëror. Mua më vjen mirë ta dëgjoj këtë dhe shpresoj që edhe ata të kenë laboratorë edhe më të mirë se tanët.

Që në fillim përfshimë edhe ata që i quajtmë laborantë. Kemi disa njerëz shumë të nderuar si profesor Besniku, Turi, Ladi, etj. Në fakt, janë ata që drejtojnë laboratorët. Nuk kanë tituj akademikë, por përvoja e tyre jetësore dhe praktike i bën personat kyç për transmetimin e dijeve teknike. Ishte sfidë në fillim, por sot mund të them se laboratorit është arma jonë më e fortë.

Pse ishte e nevojshme ofrimi i programeve 2-vjeçare të studimit dhe cila ishte qasja e tregut të punës për këtë lloj shkollimi?

Sistemi i Bolonjës është një pikë orientuese që të ndihmon të kuptosh sesi funksionon arsimit në Europë dhe më gjerë. Në këtë sistem, niveli 4 është arsimit i mesëm, niveli 6 është arsimit i lartë (bachelor), 7 masteri dhe 8 doktoratura.

Niveli që mungonte ishte niveli 5. Duke e studiuar me kujdes, pamë se ky nivel ofron arsim për një sërë profesionesh shumë të kërkuara në Europë. Kjo ishte shtysa kryesore që na nxiti. E dinim shumë mirë se përveç dhënies së dijes, që është thelbësore, ky nivel ofronte edhe formimin e aftësive praktike që kërkonte tregu.

Në Europë, për shembull, nuk mund të hapësh një servis automjetesh pa pasur një drejtues teknik. Ky drejtues teknik mund të jetë një person i diplomuar në një program 2-vjeçar profesional, po ashtu edhe një bachelor. Por diploma dyvjeçare është e mjaftueshme për t'i dhënë garanci ligjore biznesit.

E njëjta gjë vlen edhe për fusha të tjera: kompani që instalojnë sisteme elektrike, servise elektronike, sisteme hidraulike, ajrim, kondicionim, tubacione etj. Për këto profesione, ligji po shkon drejt rregullimit që të ketë një drejtues teknik të diplomuar.

Në këtë kontekst, vlera e diplomës dyvjeçare bëhet shumë e rëndësishme. Sigurisht edhe diploma 3-vjeçare ka peshën e vet, por dua të theksoj dyvjeçaren, sepse në Shqipëri kemi disa kushte të veçanta. Për shembull, një student me mesatare nën 6.5 nuk mund të ndjekë një bachelor (me përjashtime si sportet). Për ata që kanë prirje teknike, por nuk e kanë mesataren e nevojshme, zgjidhja optimale është kolegji profesional 2-vjeçar.

Kjo ka bërë që vitet e fundit kërkesa të jetë më e madhe. Edhe universitetet publike tashmë ofrojnë diploma të këtij niveli, dhe në sektorin privat janë shtuar ndjeshëm programet 2-vjeçare.

Ka qenë një rrugëtim interesant, që ka ecur paralelisht me rregullimin e tregut të punës. Kur ka kërkesë nga tregu, institucionet arsimore – publike dhe private – reagojnë. Universitetet publike, falë ligjit që u jep një farë autonomie, janë përshtatur. Sektori privat e ka më të lehtë.

Ne jemi krenarë që ishim të parët që e tentuam dhe e realizuam këtë formë arsimit të lartë dyvjeçar. Mendoj se kemi vendosur standarde dhe jam i bindur se jemi ndër më të mirët në treg për këtë lloj diplome. Kjo bindje na dha guximin që pas dhjetë vitesh përvojë, të hidhnim hapin tjetër.

Pas dhjetë vjetësh në arsimin e lartë ju hodhët një hap të guximshëm, duke e kthyer kolegjin profesional në kolegjin universitar. Tirana College of Technology, krahas programeve 2-vjeçare ofroni edhe ato 3 vjeçare. Pse ndodhi ky kalim?

Siç themi shpesh, “e kemi matur shtatë herë dhe e kemi prerë një herë”. Ne që merremi me biznes, gjithmonë shohim me kujdes tregun dhe fuqinë e tij potenciale. Ishte një hap i guximshëm, por i kalkuluar.

Të hedhësh këtë hap nënkupton kosto të reja: staf pedagogjik, sistem pagash, angazhim të stafit, infrastrukturë, struktura të brendshme, departamente që do të ktheheshin në fakultete. Ne i morëm parasysh të gjitha, edhe faktin që popullsia është në rënie – nga 65 mijë maturantë para disa viteve kemi rënë në rreth 30 mijë. Në këto kushte, nuk do të guxonim nëse nuk do të ishim të bindur se produkti ynë është i vlefshëm dhe se kushdo që zgjedh këtë shkollë, bën zgjedhjen e duhur.

Në KPT dhe tashmë në TCT, udhëtimi nuk është i lehtë. Nuk është një diplomë që merret thjesht. Bëhet fjalë për inxhinieri, për pedagogë të shquar që i kanë dhënë peshë këtij sektori: profesor Andonaq Londo, profesor Luan Kaçanaj, Maringlen Gjoni, Pirro Çipo, Antoneta Dedja, profesor Shpëtim Bozdo, Marjeta Dhima, Pirro Dhimitri dhe të tjerë. Janë emra shumë të njohur që nuk e vendosin lehtë emrin e tyre në një diplomë.

Prandaj të gjithë ata që kanë aplikuar për të studiuar në TCT, i siguroj se udhëtimi nuk do të jetë i lehtë, por do të jetë shumë i bukur. Do të mësojnë shumë dhe në fund do të kenë një diplomë që ia vlen vërtet. Ndoshta slogani “çelësi i suksesit” tingëllon si klishe, por në rastin tonë diploma është realisht një çelës – një çelës i fortë, si ai anglez që hap shumë dyer.

Ne jemi treguar shumë të kujdesshëm edhe në kuotat që kemi kërkuar. Nuk kemi ekzagjeruar me numrin e studentëve, sepse është një natyrë studimi ku nuk mund të kesh klasa masive. Puna është e lidhur me laboratorët, ndaj kemi kërkuar aq kuota sa mendojmë se mund të përballojmë për të ofruar mësimdhënie me cilësi shumë të lartë.

Kjo lidhet ngushtë me laboratorët dhe praktikën – arma jonë më e fortë dhe ajo që do të vazhdojë të na dallojë. Ne e shohim të domosdoshme që studentët të prekin vetë realitetin me të cilin do të përballen nesër.


Tregu i punës po ridimensionohet, duke kërkuar, për profesione të caktuara, aftësi të reja të fituara në kohë të shkurtër. Përveç diplomave 2-vjeçare, që mbetet shtyllë e fortë e TCT-së, ju synoni edhe ofrim-

in e kurseve të specializuara. Çfarë oportunitetesh të tjera ka një i ri që studion në TCT?

Shkolla e Lartë ka dy dimensione: atë horizontal dhe atë vertikal. Vertikali nënkupton shtrirjen në cikle të ndryshme: dyvjeçar, trevjeçar, pesëvjeçar, doktoraturë, madje edhe grada të tjera si asistent, profesor i asociuar, profesor i plotë, doktor i shkencave. Kjo është shtrirja vertikale.

Por ne kemi parë edhe një dimension tjetër. Në përgjithësi, shqiptarët shohin gjithmonë se çfarë është më lart, por unë besoj fort edhe tek ajo që është më poshtë se dyvjeçari.

Përveç faktit që dyvjeçari do të mbetet arma jonë më e fortë, ne kemi ndërtuar një strategji që fokusohet tek ciklet më të shkurtra: 1-vjeçare, 9-mujore, 6-mujore, 3-mujore apo 2-mujore. Unë besoj shumë se dinamika e



profesioneve do të ndryshojë me ritme të shpejta, sidomos me hyrjen e inteligjencës artificiale. Kjo teknologji po transformon tregun e punës me shpejtësi të jashtëzakonshme.

Askush nuk besonte se brenda një kohe kaq të shkurtër do të kishte një kërkesë kaq të madhe për instalues të paneleve diellore. Në Shqipëri ka një bum të momentit dhe, në një kuptim, na ka gjetur të papërgatitur. Por ne do të ofrojmë kurse të posaçme për këtë.

E njëjta gjë vlen edhe për gazifikimin. Kishte shumë pritshmëri që ai të ecte me ritme të shpejta, sidomos pas TAP-it. Ndoshta për shkak të klimës në vend nuk pati përhapjen e parashikuar, por sërish sot të gjitha hotelet dhe ambientet e shërbimit përdorin gazin për arsye kostosh. Edhe për këtë sektor është i domosdoshëm një kurs i mirëfilltë për të përgatitur profesionistë.



Kurse të tilla nuk janë të rëndësishme vetëm për tregun e brendshëm, por edhe për tregun europian. Në fakt, ne shpesh e them se një i diplomuar tek ne mund të përballlet me dinjitet me çdo ofertë pune në Gjermani apo kudo tjetër në Europë. Këtë e them për të qenë korrekt me marketingun, por brenda vetes ndiej një dhimbje – sepse nuk do të doja kurrë që një student i yni të përgatitej, shoqëria jonë të paguante për formimin e tij, dhe më pas ai të largohej jashtë, ndërkohë që ne kemi shumë nevojë për ta.

Megjithatë, realiteti është që Shqipëria po kthehet gjithnjë e më shumë në pjesë të Europës, në të gjitha kuptimet. Nuk e them nga ndonjë qasje politike, por faktet janë të dukshme: qytetet kryesore sot janë bërë vërtet europiane. Madje edhe investimet në fshatra kanë ngritur një standard tjetër. Rregullimi i territorit ka sjellë një cilësi më të mirë jete dhe një standard më të krahasueshëm me vendet e zhvilluara.

Ndaj sot nuk e them vetëm si një slogan, por e besoj me shpirt: studentët tanë jo vetëm që mund të punësohen jashtë, por edhe këtu, në Shqipëri, mund të jenë më të mirëpaguar se në Europë – jo vetëm në nivel të të ardhurave, por edhe në nivel të cilësisë së jetës.

Kjo është arsyeja pse u them jo vetëm studentëve që diplomohen tani, por edhe atyre që janë diplomuar vite më parë dhe kanë histori suksesi kudo: kthehuni, sepse ia vlen barra qiranë.

Nga humanitetet në UET te shkencat ekzakte në KPT, duket se ky kapërcim ka qenë i natyrshëm për ju.

Ashtu nisi. Kujtoj kur ishim në godinën e parë, pranë ambasadës amerikane. Unë këmbëngula shumë për hapjen e Fakultetit të Ekonomisë. Në fillim hasa rezistencë nga disa prej themeluesve të tjerë, por Henri e kuptoi potencialin dhe rezultoi të ishte një histori suksesi.

Tashmë UET është bërë një gjigant, ka përfshirë shumë fusha: inxhinieritë, mjekësinë, arkitekturën, artet, shkencat sociale, por baza ishte humanitetet. Ndoshta për shkak të formimit tim si ekonomist, si dikush që gjithmonë e ka dashur matematikën, u fokusova tek shkencat ekzakte. Në fillim pata një lloj zhgënjimi, sepse prisnim shifra më të mëdha. Por pas pandemisë ndodhi një lloj “reset” i shoqërisë. Njerëzit u bënë më pragmatistë. Nuk e di se në cilën pikë ndodhi ky ndryshim, por duket se shoqëria kishte ecur shumë shpejt pa reflektuar, dhe pandemia solli një rikthim tek vlerat themelore. Sot efektet e saj janë pozitive sidomos për shkencat ekzakte dhe veçanërisht inxhinieritë.



ANGJELOS LAMÇAJ

Ekselenti i Diplomës Profesionale në TCT

Jo vetëm një student i diplomuar në programin “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi” Tirana College of Technology, Angjelos Lamçaj është një i ri plot ëndrra dhe ambicie për të ardhmen

“Mirëmbërëma të gjithëve! Çuna...!” Entuziazmi i shqiptimit të këtyre fjalëve, ndërsa shikimin e hodhi në publik, paralajmëroi se ajo që do të vinte pas nuk do të ishte një fjalim i zakonshëm. Ose të paktën, nuk do të ishte një nga ato fjalimet pak klishe, të ngathëta apo të stërzgjatura. Më shumë se fjalët, ishte mënyra e të thënit. Nuk iu desh retorika e Aristotelit, as udhëzimet e mjeshtrave të komunikimit; i mjaftuan tre minuta, disa fjalë të singerta, veshur me gëzimin rinor, për të rrëmbyer duartrokjetet dhe zemrën e audiencës.

Angjelos Lamçaj ishte student i përzgjedhur për të përshëndetur në ceremoninë e diplomimit të Kolegjit Profesional të Tiranës, tashmë Tirana College of Technology, mbajtur më 9 korrik. Ai mbylli studimet profesionale për “Teknologji Ajrimi dhe Kondicionimi”, një nga dhjetë programet 2- vjeçare që ka ofruar ky kolegji.

Për vitin akademik 2025-2026, kolegji vjen i ristrukturuar dhe i shndërruar në Kolegjin Universitar “Tirana College of Technology”, duke ofruar krahas programeve profesionale edhe katër programe në ciklin bachelor me një natyrë tërësisht aplikative.

Më të vështirë se çdo provim të dhënë deri më tani, e cilësoi ngjitjen në podium Angjelos ku ndau me drejtuesit e institucionit, pedagogët, bashkëstudentët dhe prindërit, historinë dhe mirënjohjen e tij. Pas mbarimit të gjimnazit ishte i paqartë për profesionin që do të mer-

rte. Kur vizitoi ambientet e Kolegjit Profesional të Tiranës, u njoh me stafin, programet dhe mundësitë e ofruara, vendosi që të bëhej student i tij. “Gjatë këtyre dy viteve, Kolegji nuk ishte thjesht një institucion, ishte një shtëpi e dytë për mua”, theksoi ai.

Ovacionet e mbarimit të fjalës u shoqëruan me përgëzime dhe fjalët më të mira nga njerëz të afërt, të njohur dhe të panjohur. Por duket se më i surprizuar i në këtë mes mbeti babai i tij. “A e kishe shkruar vetë fjalimin?”, ishte pyetja e tij kur u ulën në kafe, që përtej habitës, shprehte krenarinë e prindit për djalin çapkën dhe të rrëmbyer, që tashmë shfaqte një tjetër anë të karakterit dhe maturisë së tij.

“Nuk e di si po e përmbaja veten në podium”, tregon ai me të qeshur. “Unë jam hiperaktiv dhe nuk më lë energjia të rri në vend.” Ndoshta ka qenë kjo cilësi e cila ka shtyrë që të marrë gjithmonë iniciativën për të prezantuar në auditor projektet apo detyrat e kursit.

Shumë ide ka për të ardhmen e vet. Nuk i pëlqen të rrijë në një punë për hir të pagesës, nëse ajo nuk i ofron asnjë gjë të re për të mësuar dhe për t’u zhvilluar. Aktualisht punon në dy të tilla, njëra që lidhet me profesionin e tij dhe formimin e marrë nga arsimimi.

Ka dhe një pasion, dëshiron të bëhet influencer, e nuk përjashton mundësinë që subjekti të jetë profesioni i tij ose kalistenika, arti i përdorimit të peshës së trupit si

rezistencë për të zhvilluar muskujt. I pëlqen stërvitja fizike, një element që Angelos e ka marrë nga Greqia, vendi ku lindi, dhe jetoi me familjen deri në moshën 4-vjeçare.

Edhe pse gjendja ekonomike nuk ishte e vështirë, Angelos thotë se aty përjetuan racizmin. E ndjenë veçimin dhe trajtimin ndryshe nga pjesa tjetër e fëmijëve grekë që kur ishte në kopsht me motrën, në Selanik. Kjo ishte e padurueshme për prindërit e tij. Vendosën të lënë ato vite jetë pas dhe të rikthehen në vendlindje, në Ballsh të Mallakastrës. Qëndruan aty për 7 vite dhe u zhvendosën në kryeqytet.

Lëvizje të tilla kanë lënë gjurmët e tyre në vitet e rritjes së Angelos. Ndryshimi i shpeshtë i shoqërisë, nevoja për t'u përshtatur me të gjitha grupet, mungesa e një vëmendjeje vëllazërore, që orienton dhe këshillon, duke qenë se babai i tij ishte gjithë kohës në punë dhe vëllai është më i vogël se ai, bënë që të ishte i ekspozuar ndaj grupeve shoqërore të ndryshme. "Nëse do të kthehesha pas, disa

gjëra do t'i bëja ndryshe", thotë më tej.

Pavarësisht rrugëtimit të vështirë, me peripecitë e veta, ka qenë edhe një rrugë njohjeje dhe vetëzbulimi. I është dashur të mësojë duke provuar, e prej tyre është ndërgjegjësuar dhe ka kuptuar limitet. Ka kuptuar se kush është sot, çfarë duhet të bëjë dhe çfarë i dëshiron vetes. Edhe pse 20 vjeç, ai rend i emocionuar drejt së ardhmes. E dëshiron fort ëndrrën amerikane, të shkelë në tokën e mundësive e të realizojë ato që tashmë i kalojnë si mendime ngazëlluese në mendjen e tij, në ditët e qetësisë e të arratisjes nga realiteti.

"Dua kem një jetë me sa shumë gjëra dhe eksperiencia të mira. Dua të jem një profesionist i shkëlqyer në fushën time, dhe them se e kam nisur mbarë. Dua të udhëtoj, të eksploroj dhe të shikoj mundësi të reja," thotë Angelos.

Është i bindur se të gjitha këto, një ditë, do të jenë realiteti i tij dhe ëndrra të tjera do të kërkojnë rrugën e tyre të realizimit.





SUPLEMENT
PËR LETËRSINË

LETËRATURA

ENIRD MALILE
dhe absurdi i njeriut
të zakonshëm

GANI MEHMETAJ
Janë disa vepra që do t'i
hiqja nga Antologjia e
letërsisë shqipe

BEN BLUSHI

Romancieri bestseller i Tranzicionit

Mbi 100 mijë kopje të shitura. Nga "Të jetosh në ishull" të "Parajsa Artificiale", rrugëtimi i një autori që ka trazuar ujërat e letërsisë shqiptare me sukses komercial, debat publik dhe romane që nuk lënë askënd indiferent



BEN BLUSHI, ROMANCIERI BESTSELLER I TRANZICIONIT

Mbi 100 mijë kopje të shitura. Nga "Të jetosh në ishull" te "Parajsa Artificiale", rrugëtimi i një autori që ka trazuar ujërat e letërsisë shqiptare me sukses komercial, debat publik dhe romane që nuk lënë askënd indiferent



Në fund të shekullit XIX, shtypi anglistfolës i propozoi lexuesit *bestseller*-in – një kategori praktike që do t'i orientonte ata në tregun e botimeve drejt librave më popullore.

Shitjet do të thonë kërkesë, kërkesa interese dhe interesi lexim, edhe pse jo gjithmonë doemos.

Një shekull e diçka më vonë, debati se librat më të shitur nuk janë garanci e një letërsie të mirë vazhdon, me ata që renditin nga secili kah pro-të dhe kundrat e tyre. Suksesi komercial – kur një titull, një veprë letrare arrin të shënojë rekorde shitjesh për një kohë të shkurtër – apo suksesi universal, ai që e shënjon kulturalisht një shoqëri, edhe në disa breza?

Veprat e Ben Blushit janë diskutuar në të dyja frontet.

Injohur për veprimtarinë e tij gazetare-ske dhe politike, Ben Blushi iu propozua shqiptarëve në vitin 2008 si romancier.

Aspak vonë për një shkrimtar që, ndonëse ishte diplomuar në Letërsi nga Universiteti i Tiranës në fillim të viteve '90, ishte vetëm 39 vjeç kur botoi romanin e tij të parë.

Duke u kredhur thellë në histori – në shekujt XV-XVIII – duke prekur dhe sjellë në një dritë trilli krejt të re figura si Gjergj Kastrioti, Arianit Komneni e Ali Pashë Tepelena, shkrimtari i ri asokohe – i cili kishte mbajtur edhe detyra të rëndësishme si deputet në disa legjislatura apo edhe ministër i qeverive të majta – kishte prekur jo pa dashje një temë tepër sensitive.

Përmes trillit letrar të Ibrahimit, i cili konvertohet nga krishterimi në islam, romani bëhej një pasqyrë e konfliktit mes fesë, identitetit, pushtetit dhe mbijetesës.

Mbi identitetin e shqiptarëve, mes Perëndimit dhe Lindjes, mes krishterimit dhe islamit, kishin debatuar edhe pena të

njohura si Kadare e Rexhep Qosja, por romani i Blushit do të merrte tjetër jehonë. Debatu nuk e ndali librin të ishte edhe i shitur, madje aq sa të bëhej më i shituri në tregun e botimeve shqip atë vit e më tej.

Botuesja e "Toena"-s, Irena Toçi, kujton sesi e nisën botimin me 1.000 kopje fillimisht:

"... dhe arritëm të shtypnim 25.000 kopje gjithsej nga të dy formatet: ai me format klasik dhe ai xhepi", kujton Toçi. "Për ne ka qenë libri më i shitur për një periudhë kohore të shkurtër", shton botuesja, e cila në mesin e autorëve të kësaj shtëpie botuese ka edhe emra të njohur si shkrimtari Fatos Kongoli, i cili në një farë mënyre i dha formë asaj që e cilësojmë si 'letërsia e tranzicionit', duke qenë – pas Kadaresë – më i përkthyeri në frëngjisht dhe gjuhë të tjera, si edhe më i shituri.

"Pati kaq shumë interes, sepse nxiti një debat jashtëletrar që kishte të bënte me

mënyrën si Blushi kishte trajtuar për herë të parë dhe në mënyrë shumë të gjetur arsyet e mundshme të konvertimit të një pjese të shqiptarëve në fenë myslimane. Këndvështrimi i tij original nxiti një pjesë të mirë të intelektualëve të reflektonin dhe të shkruanin opinionet e tyre, sidomos mbi këtë çështje”, shton më tej botuesja, në arsyet që e bënë romanin *Të jetosh në ishull* dhe autorin e tij aq të shitur.

Debatet që erdhën pas botimit të librit u përmbodhën në një tjetër botim nga “Toena”, *Pro dhe Kundër Blushit*.

Të drejtat për ribotimin e romanit *Të jetosh në ishull* do t’i merrte shtëpia botuese universitare **UET PRESS**, duke shitur afro 6.000 kopje të tjera, që do ta çonin këtë libër në një rekord prej më shumë se 30.000 kopjesh të shitura.

Me fokusin te historia dhe rimarrja e personazheve, të cilët përmes penës së tij çmitizohen, zbërthehen apo satirizohen, Blushi përpiket – përmes një qasjeje alternative letrare – të kuptojë, sipas imagjinatës dhe leximit të tij historik, rrënjën e së keqes shqiptare.

Me botuesin e tij **UET PRESS**, sjell tituj po aq kontroversë sa romani i parë.

Në romanin *Shqipëria* – i cili u shit në rreth 17.000 kopje – ai imagjinoi një Lekë Dukagjin që krijonte Shqipërinë e tij eksperimentale me 100 fëmijë.

Një gjenezë “alla shqiptare”, që ndërthuret enkas me projektin komunist të diktatorit Hoxha – gjithashtu personazh i ripropozuar në këtë libër – si një prej fëmijëve.

Otello i tragjedisë shekspiriane, në fan-

tazinë e Blushit, bëhet *Arapi i Vlorës*, i cili u botua fillimisht nga Toena më 2009 dhe u ribotua nga UET PRESS më vonë. Ngjarjet shtrihen në vitet 1300–1400 dhe zhvillohen në dy qendra urbane të njohura të kohës, në Venedik dhe në Vlorë, marrëdhëniet politike e tregtare midis të cilave ishin mjaft intensive për periudhën. Blushi rreket që në të gjithë romanet e tij të ruajë një sfond historik, real.

Romani është një metaforë për historinë shqiptare, përballjen e saj të përhershme me pushtuesit, me fenë dhe me vetveten. Nga të dhënat e shtëpisë botuese UET PRESS, ky roman shiti rreth 6 mijë kopje.

Blushi vazhdoi të ishte protagonist edhe kur vendosi të sillte romane që nuk gjurmonin figura të së shkuarës, por i ngjanin realitetit – përmes groteskut therës në rastin e *Kandidati*, ku zgjedhjet i fiton një kandidat i vdekur, apo në *KM*. I pari arriti deri në 12 mijë kopje të shitura, ndërsa *KM 11* mijë kopje të tilla, sipas të dhënave të **UET PRESS**.

Në rastin e këtij të fundit kishte bërë përpjekjen e parë letrare për t’i çuar ngjarjet në të ardhmen.

Romani *KM* u botua më 2016-n, kur Blushi ndahej nga Partia Socialiste dhe krijonte “LIBRA”-n, partinë e tij politike, ndërsa ngjarjet rrëfohen nga viti 2020.

Pas largimit nga **UET PRESS**, Blushi botoi librin me portrete *41 sekrete* me shtëpinë botuese “Pegi”, me të cilën do të sillte edhe dy romane bestseller: *Komploti* (në vjeshtën e 2023-s) dhe, një vit më vonë, pak para Panairit të 27-të të Librit,

romanin *Parajsa Artificiale*.

Në *Komploti*, ngjarjet janë vendosur në vitin 2044, në një të ardhme distopike ku shqiptarët i tremb një ministër i importuar nga Lindja e Mesme dhe një shtet me një milion banorë, ku nuk mungojnë tezat e autorit ndaj islamit.

Idetë që ravijëzojnë këtë fiksjon letrar, ai i kishte trajtuar si ese dhjetë vjet më parë në librin *Hëna e Shqipërisë*.



Në Panairin e Librit, në vjeshtën e 2023-s, që shënon ndoshta edhe kulmin e shitjeve të një produkti pak të kërkuar në treg si libri, *Komploti* u shpall libri më i shitur i asaj jave, me afro 2.500 kopje. Sipas botueses Loreta Berhami, Blushi është ndër autorët shqiptarë më të shitur të shtëpisë botuese “Pegi”, duke shënuar një numër të lartë shitjesh gjatë panairit. Tre librat e fundit të tij kanë shitur gjithsej rreth 9.000 kopje, duke kulmuar me *Komploti* (5.000 kopje), *41 sekrete* (2.000 kopje) dhe *Parajsa Artificiale* (2.000 kopje).

Por nuk ishte hera e parë që një roman i Blushit – tashmë autor i disa titujve – të shpallej si më i shituri në një ngjarje si Panairi i Librit.

Romani *Kryeministri* u rendit nga organizatorët e Panairit të 19-të të Librit si një nga librat më të shitur gjatë ditëve të panairit, me 4.000 kopje.

Një vit më herët, më 2015-n, më i shituri i panairit ishte shpallur *Kandidati* me 3.500 kopje.

Sipas Teodor Mishës, themeluesit të librarisë “Adrion”, nga më të mëdhatë në vend, në dhjetë apo pesë vitet e fundit, Ben Blushi renditet mes më të shiturve.



Në një listë me autorët më të shitur pas viteve '90, libraria "Adrion" e rendit Ben Blushin si të pestin më të shitur, pas emrave si Kadare, Agolli, Kongoli dhe Bashkim Shehu.

Mes romaneve të tij më të shitur kryeson *Komploti*, i ndjekur nga *41 sekrete* dhe *Parajsja Artificiale*.

Sipas librarisë online "Shtëpia e Librit", romani *Shqipëria* i Ben Blushit renditet ndër bestseller-ët pas vitit 2010, në vendin e 48-të, ndërsa në pesëshen më të shitur tri vendet e para i zënë librat e Kadaresë (*Prilli i thyer*, *Darka e gabuar* dhe *Pallati i ëndrrave*).

Në vend të dytë renditet *Enver Hoxha* i Blendi Fevziut, ndërsa më i shituri është klasiku *Tregime të moçme shqiptare* i Mitrush Kutelit.

Kur në listat e ngushta të platformave online shoh të renditur mes autorëve bestseller emra si ai i shkrimtarit Ismail Kadare

– i kremtuar për letërsinë e tij, i nderuar me shumë çmime prestigjioze ndërkom-bëtare dhe kandidat i përherëshëm i shqiptarëve për Nobelin e Letërsisë – duket se dikotomia mes suksesit komercial dhe atij të ndikimit në shoqëri zhbëhet.

Kufiri, mendojnë disa, është zbehur. Shkrimtarë si Margaret Atwood, Haruki Murakami, Elena Ferrante apo Orhan Pamuk arrijnë njëherazi sukses komercial dhe vlerë letrare.

Në këtë pikë, librat e Ben Blushit nuk kanë njohur vetëm sukses komercial, duke e bërë atë një prej autorëve – ose më ngushtësisht, romancierëve bestseller – të tranzicionit.

Ai u shpall autori më i mirë i vitit në Pannairin e Librit të vitit 2009 me romanin *Otello, Arapi i Vlorës*.

Disa vjet më vonë, më 2014, Blushi fitoi **Çmimin European të Letërsisë** me *Otello-n* e tij, ku sa rishpik personazhet shek-

spirianë, aq edhe na prezanton me personazhe historike si Balsha II apo Komita Muzaka.

Librat e tij nuk kanë kaluar vetëm në termat e shitjeve.

Pothuaj asnjëherë media – jo vetëm ajo kulturore – apo opinionin publik nuk ka qëndruar indiferent ndaj romaneve të Blushit, të cilat disa i kanë cilësuar edhe si fenomen në letërsinë shqiptare. Qoftë tema e ndjeshme e religjioneve, veçanërisht ajo e islamit, distopitë si të *Komploti*, satirat politike si të *Kandidati*, apo rimarrja e personazheve historike dhe loja me ta në trillin letrar, e bëjnë Ben Blushin të jetë në qendër të vëmendjes sapo boton një libër të ri.

E njëjta ndodhi edhe vitin e kaluar me romanin *Parajsja Artificiale* – një roman ku ndërthuren historia, luftërat tradicionale dhe konfliktet kibernetike, fetë dhe inteligjenca artificiale.

Edhe në këtë roman, ku sa satirizon me personazhe aktualë e historikë, aq edhe përpiqet të ndërtojë një skenar distopik, autori ofron edhe një të ardhme utopike – ndryshe nga ata që e shohin të ardhmen e njerëzimit të rrezikuar nga inteligjenca artificiale.

Ai shkon deri aty sa, përmes teknikës së metanarrativës apo metafiksionit, luan me veten, duke u shfaqur si alter egoja e trilluar Simon Shuteri – tashmë protagonist në tre prej romaneve të tij – dhe njëkohësisht duke e bërë personazh autorin e librit, Ben Blushi, si edhe të përdorë edhe nofken "profeti", me të cilën e kanë pagëzuar disa me ironi.

Në debatin mes letërsisë së mirë dhe asaj bestseller, Ben Blushi do të qëndrojë gjithnjë në mes – një emër që premtion të trazojë ujërat me çdo vepër të re dhe që nuk lë indiferent thujse askënd, qofshin simpatizantë apo kundërshtarë të zellshëm të letërsisë apo të ideve që ai shpërndan përmes saj.

Siç i quan vetë ai, ata janë "ushtarët e tij prej balte", me të cilët luan dhe i vendos në betejat e ndryshme të imagjinatës së tij letrare.





ENIRD MALILE DHE ABSURDI I NJERIUT TË ZAKONSHËM

Në vend që të ofrojë përgjigje, “Planeti Leshtor” i Enird Maliles hap dritare të reja mbi vetë qenien dhe kuptimin e saj. Lexuesi ndihet si autori i kësaj përmbledhjeje dhe si personazh i saj – i hedhur brenda absurdit të përditshëm, duke përjetuar çdo fiksim, humbje dhe zbrazëti, por edhe humorin, dashurinë dhe intimitetin që jeta i ofron

- Çfarë po diskutojmë tamam? - ia ktheu ajo pak e indinjuar.
- Çështjen e leshit, - iu gjegj menjëherë.
- Ai është kudo, apo jo?!
- Po është. Shumë gjëra janë.
- Fqinji ynë vdiq dje në mbrëmje.
- Po, e mora vesh kur po ngjitesha.
- E njihja.
- E di, edhe unë.
- E njihja prej vitesh, kam studiuar bashkë me djalin e tij.
- Njeri babaxhan, - tha ajo.
- Po. Dhe me shumë qime në fytyrë.
- Ç'të ka kapur me këtë punë?
- Kot ashtu.
- Sidoqoftë është e vërtetë, - vazhdoi ai.
- Nuk e di nëse vdekja e ka gjetur të parruar:
- A rruhen të vdekurit?
- Nuk jam i sigurt. Unë do të preferoja të më rruanin.
- Ç'ne kështu? Ti rruhesh rrallë.
- Në jetë po. I vdekur është tjetër gjë.
- E pse kështu?
- Nuk e di, do të doja që të tjerët të më shihnin pa ndërmjetësinë e qimeve. Ashtu siç kam lindur...
- Ky dialog i thjeshtë, por absurd, që hap

një nga tregimet e Enird Maliles në vëllimin “Planeti Leshtor” e zhyt lexuesin në një atmosferë të çuditshme, që kujton romanin *Oh* të Anton Pashkut (1971), veprën që e futi letërsinë shqipe në territorin e romanit modern dhe introspektiv psikologjik.

Si Pashku dikur, Malile krijon një botë ku absurdi nuk është koncept abstrakt, por pjesë e përditshmërisë.

Enird Malile është një nga përfaqësuesit më interesantë të brezit të ri të shkrimtarëve shqiptarë. Ai është autor tregimesh të shkurtra ku ndërthuren detajet e të përditshmes me absurditetin dhe filozofinë, duke krijuar një narracion që shkon përtej realitetit të dukshëm. Proza e tij, e qetë por njëkohësisht e mprehtë, zbulon të fshehtat që jetojnë nën sipërfaqen e ngjarjeve të zakonshme dhe i jep lexuesit një ndjesi të thellë introspektive.

Stili i Maliles është i dallueshëm për tonin e tij urban dhe nuancat ekzistencialiste, ku ndihen qartë formimi dhe përvoja e tij si psikolog. Prej vitesh, ai punon si psikolog klinik dhe i zhvillimit, profesion i cili ka ndikuar në ndërtimin e personazheve dhe situatave letrare, duke u dhënë një dimension psikologjik dhe njerëzor të veçantë.

Libri i tij i parë, *Planeti leshtor*, përfaqëson hyrjen e tij në botën e botimeve dhe u prit me interes për originalitetin e tematikës dhe forcën shprehëse të gjuhës. Në vitin 2025, ai u rendit finalist i Çmimit Letrar Kadare, një nga vlerësimet më prestigjioze në letërsinë shqipe, duke e konsoliduar si një zë të rëndësishëm të skenës letrare.

Krijimtaria e Enird Maliles reflekton shpirtin e një brezi autorësh që eksplorojnë jetën urbane, ekzistencën dhe përplasjen mes botës së jashtme dhe asaj të brendshme, duke sjellë një përvojë letrare moderne, të guximshme dhe filozofikisht të ngjeshur për lexuesin shqiptar

Tradita ekzistencialiste – me Jean-Paul Sartre, Albert Camus, dhe deri tek Dosto-

evsky si pararendës – vendosi në qendër individin e zakonshëm: studentë, punonjës zyrash, njerëz të përditshëm që përballen me lirinë, kotësinë dhe absurditetin. Ashtu si Mërsoi i Camus-it tek I Huaji, këta individë thyejnë pritshmëritë e lexuesit, duke treguar se kriza më e madhe nuk lind nga epikat, por nga përditshmëria. Edhe tek Malile hasim të njëjtën figurë: individë të zakonshëm, shpesh të fiksuar, të brishtë, të thjeshtë, por që jetojnë në gjendje të vazhdueshme ankthi dhe përplasjeje me vetveten.

Pas ekzistencialistëve, letërsia postmoderne trashëgoi dyshimin ndaj “rrëfimeve të mëdha” (termini i Lyotard-it). Në vend të heroit epik, dolën figura fragmentare, të shpërndara në botën e konsumit, burokracisë dhe teknologjisë. Personazhet e Thomas Pynchon-it, Don DeLillo-s, Samuel Beckett-it apo Italo Calvino-s nuk janë heronj; janë qenie të zakonshme, të hutuar, shpesh qesharake, që përpiqen të gjejnë kuptim në një botë të tejmbushur me informacion dhe absurditete.

Malile e vazhdon këtë traditë.

Personazhet e tij – një burrë që përballlet me plakjen në *Pasqyra*, një i ri i mbërthyer pas komenteve online tek *Komentuesi*, një burokrat i lodhur në *E njëjta gjë* – nuk kanë kurrfarë madhështie.

Janë njerëz të zakonshëm, të hedhur nga përditshmëria në absurditetet pa rrugëdalje.

Dialogu hyrës, është i thjeshtë, por menjëherë shkund lexuesin. Fjalët e thjeshta e zhytin në një atmosferë që nuk është vetëm ironike, por edhe tronditëse.

Malile duket sikur shkon në gjurmët e ekzistencialistëve dhe postmodernistëve por e shtyn prozën e tij edhe më tej: ai nuk përpriqet të shpjegojë absurditetin, as të luftojë me të; thjesht e vendos personazhin brenda tij dhe e le të jetojë brenda absurditeteve.

Psikologjia e personazheve është e dukshme: obsesivë, kompulsivë, viktimatë varësive, mizantropë, të mbërthyer nga fiksime të vogla, ndjenja faji dhe rituale të

përditshme, që duket se e robotizojnë qenien njerëzore. Janë individë që lexuesi mund t'i njohë përditë, por që mbartin çarje të brendshme, zbrazëti dhe ankth. Kjo e bën prozën e Maliles urbane, por edhe universale.

Stili është lakonik dhe i thjeshtë, pa zbukurime të panevojshme. Është fragmentar, si të shikosh një mozaik jete urbane: ai nuk moralizon, thjesht vendos para lexuesit një copë jete, një situatë të zakonshme që papritur bëhet e pazakontë. Kjo është forca e tij: të bëjë lexuesin pjesë të absurdit.

Temat që trajton janë të njohura dhe të shumta: plakja dhe imazhi për veten (*Pasqyra*), vetmia dhe izolimi (*Orfelinët*), hipokrizia e institucioneve fetare (*Hirësi*) apo ngritja e kulteve të reja në epokën e Inteligjencës Artificiale (*Në Linjë*), robotizimi i punës moderne ku personazhet vejnë si sizifë të zyrave (*Solidariteti, E njëjta gjë, Mbledhja*), varësia nga teknologjia dhe rrjetet sociale (*Komentuesi*), që prekin temën e madhe të vetmisë dhe zhveshjes nga njerëzorja të individit, që në thelb është kafshë sociale.

Ai hyn në thellësi të varësive moderne, duke i parë jo si fenomene të jashtme, por si mekanizma psikologjikë që gërryejnë individin.

Nuk ndalet vetëm te absurdi i përditshëm: tregimet e tij evokojnë tragjedi historike – emigracioni shqiptar në det të hapur, pushkatimet politike – por pa patetikë apo nostalgji.

Këto janë pjesë e të njëjtit absurditet ku njeriu nuk ka rrugëdalje.

Megjithatë, brenda kësaj bote të thyer ka edhe humor, dashuri dhe intimitet.

Tek tregime si *Pse s'ma vari macja e fqinjës* apo *Vendtakimi*, absurdi merr ngjyra llozjare, erotike, por gjithmonë me një hije vetmie dhe zbrazëti.

Në *Kthimi* dhe *Një ditë do të ndodhë*, njeriu përballlet me humbjen dhe plakjen, duke e bërë lexuesin të ndiejë kotësinë e jetës. Por Malile shpërfaq gjithashtu momente që të bëjnë të kuptosh se ia vlen të jetohej absurdi.

Lexuesi nuk gjen heronj te *Planeti Leshtor*. Nuk ka kuptime të mëdha apo përgjigje të prera. Ajo që gjen është përjetimi i drejtpërdrejtë i absurdit: në ritualet e vogla, marrëdhëniet e çuditshme, fiksime dhe humbjet e njeriut modern.

Malile i sjell këto figura në një kontekst shqiptar, por i zhvesh nga folklorikja dhe i kthen në universale.

Ai nuk sheh absurditetin si një enigmë për t'u zgjidhur, por si një kusht natyror të jetës. Dhe kjo e bën letërsinë e tij jo vetëm të lexueshme, por edhe të afërt me çdo njeri që ka ndier zbrazëtinë e përditshmërisë.

Në fund, tregimet e Maliles dëshmojnë se heroi modern nuk është hero: është njeriu i zakonshëm, në apartamentin e tij, në zyrë, në kafene, në linjë. Dhe është pikërisht aty, brenda zakonshmërisë së mbushur me absurditet, ku letërsia e tij gjen kuptimin.

Dhe ndoshta pjesa më e veçantë e leximit të tij është kjo: secili nga ne, ndërsa lexon këto tregime, ndihet si autori i kësaj përmbledhjeje dhe si personazh i saj – i hedhur brenda absurdit të përditshëm, duke përjetuar çdo fiksion, humbje dhe zbrazëti, por edhe humorin, dashurinë dhe intimitetin që jeta i ofron.

E ashtuquajtura ADN letrare e Enird Maliles shfaqet qartë në këtë vepër: një stil i mprehtë dhe njëkohësisht i brishtë, ku detajet më të vogla – një korridor i errët, një cigare e harruar në ballkon, një mace e paarritshme – mbartin domethënie të thella filozofike.

Planeti Leshtor është një libër ku e zakonshmja shndërrohet në metaforë dhe ku çdo çast i vogël përfaqëson një univers të tërë ndjesish.

Një thirrje për ta parë jetën ndryshe

Planeti Leshtor nuk është vetëm një vepër letrare, por një udhëzues i heshtur për të menduar më thellë mbi njeriun dhe shoqërinë. Ky është edhe mesazhi më i fortë i artit: fuqia për të shkundur përfytyrimet tona, përtej gjuhës, kulturës apo ndarjeve të tjera.



Vepra e parë që ka lexuar, e fundit që ka në duar, personazhet më të arrira nga pena e tij, ata që pret t'i gdhendë në të ardhmen, autorët më të nënvlerësuar e më të mbivlerësuarit, proza më e fuqishme shqipe, shkrimtarët e mëdhenj që ka pasur model... si edhe ca mendime mbi antologjitë e letërsisë shqipe

GANI MEHMETAJ

Janë disa vepra që do t'i hiqja nga Antologjia e letërsisë shqipe

1. Cila ka qenë vepra e parë që keni lexuar nga letërsia shqipe dhe ç'përsh-typje ju ka lënë?

Nga ajo që mbaj në mend është "Lugjet e verdha" të shkrimtarit për fëmijë Rexhep Hoxha. Një përrallë interesante dhe me imagjinatë. Më kujtohet se më mbante pezull, me padurim e lexoja duke i ndjekur ngjarjet dhe bëmat e personazheve.

2. Po vepra e fundit që keni lexuar nga letërsia shqipe dhe çfarë shijeje ju la në lexim?

Fatos Kongoli me romanin "Gjemia e mbytur" ka një qasje interesante që herë më duket si ballo e fantazmave, herë si përftim i së kaluarës së errët të Shqipërisë. Çfarë përshtypje më la? E lexova dhe pastaj i thashë vetes: më mirë të mos e kisha lex-

uar! Por prapë do ta lexoja. "Gjemia e mbytur" është ndryshe nga sa kam lexuar nga autorë shqiptarë. Të shijon dhe të shtie në përsiatje.

3. Kush është, sipas jush, autori i mbivlerësuar i letërsisë shqipe dhe si e shpjegoni?

Është shkruar më së shumti për Ismail Kadarenë, por ai edhe më tutje është njëshi. Në të kaluarën më ka penguar një përpjekje për të nxjerrë tre autorë shqiptarë më të suksesshëm. Sikur donin t'i barazonin: Ismail Kadarenë, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapin. Secili prej tyre e kishte vendin e veçantë në letërsi, por ishin të ndryshëm me stil, tema, llojin e letërsisë dhe mënyrën e rrëfimit. Pastaj edhe shkalla e popullaritetit nuk ishte e njëjtë. I

kanë barazuar, ndërsa nuk ishin të barabartë.

Ndërkaq, i kanë mbivlerësuar jo një por disa shkrimtarë, që sot nuk lënë gjurmë në letërsinë shqipe. Është bërë zhurmë e madhe për ta, por kritika nuk i ndihmoi të mbeten në sipërfaqe. "Shumë zhurmë për asgjë", më duket se e ka titullin një roman. Kështu ishte për disa autorë. Koha i shleu. Në të njëjtën mënyrë pas viteve të nëntëdhjetë i nxorën disa shkrimtarë "disidentë" që nuk ishin të tillë, sepse pushteti i atëherëshëm nuk lejonte disidencë, i vriste a i burgoste. Në emër të disidentizmit i bënë yje, ndërsa nuk kishin vlera.

4. Po autori i nënvlerësuar nga letërsia shqipe?

Azem Shkreli me tregimet "Sytë e Evës"

dhe romanin “Karvani i bardhë”, të shkruara para më shumë se pesëdhjetë vjetësh. Të dy prozat janë shkruar në gegnishte. Romanin “Karvani i bardhë” e ka shkruar në moshën 17-vjeçare. Autori e zgjeroi në fund të viteve Nëntëdhjetë. Mua më shijoi edhe me plotësime. Do ta vija në kreun e letërsisë shqipe, edhe pse nuk e përjetoja njëjtë si versionin e parë, që ka lënë gjurmë.

Janë edhe tregimet e Anton Pashkut, po ashtu të shkruara në gegnishte, që më duken shumë të mira. Pashku e ka një prozë të veçantë, pak të mbyllur por ndryshe nga autorë të tjerë.

5. Kë, prej personazheve që keni krijuar, e shihni më të realizuarin?

Më duket se është kolonia Milena nga romani “Muri i heshtjes” e dashuruar në shqiptarin vendës, por që ka një dramë të fuqishme. Nuk e ka fundin tragjik të Xhullietës e as të Ofelisë, por ka një fatkeqësi tronditëse që ia shkaktojnë njerëzit e kombit të saj.

Do ta veçoja edhe personazhin, Daorsi nga romani “Kalorësit e Dardanisë”, një figurë e veçantë e një kohe që lufton dhe vritet për një ideal. Ai do të bëhej hero që mbahet në mend për një kohë të gjatë po të bëhej film, sepse e kam menduar film-spektakël. E dua atë figurë.

6. A ka ndonjë personazh që nuk këni mundur ta krijoni?

Është një tip i vajzës a gruas së veçantë nga novela “Raporti i Mitro Agait”, joshëse dhe e misterhme që jam përpjekur ta krijoj, por nuk kam arritur për shumë arsye. Më ikte portreti i saj, në veçanti më ikte karakteri dhe sharmi i brendshëm që e bëjnë të veçantë. Do ta plotësoj në versionin e ri, që e kam në plan krijues. Do të më mbetet peng po nuk e bëra një figurë të veçantë të femrës, ndryshe nga klishtë që jemi mësuar të lexojmë.

7. Kush është heroi apo personazhi që adhuroni nga letërsia shqipe dhe pse?

Nuk e kam ndonjë hero të veçantë.

8. Po personazhi që e urreni më shumë nga letërsia shqipe?

Prapë nuk kam ndonjë përgjigje konkrete. I solla nëpër kokë disa figura, por nuk më kishte mbetur asnjë fije urrejtje për asnjërin prej tyre.

9. Cilën vepër, nga Antologjia e letërsisë Shqipe, e vlerësoni si më të mirën dhe pse?

“E madhe është gjëma e mëkatit” e Mitrush Kutelit është proza më e fuqishme në letërsinë shqipe. Është e veçantë dhe

emocionuese, dramatike, ka pasurinë gjuhësore dhe ka stil. Nuk e di sa e ka veçuar kritika letrare, sepse nuk i kam lexuar, por është prozë që të trondit me dramaticitetin dhe me stilin. Ka figura, atmosferë dhe narracion që është pothuajse skenar i gatshëm për film. Mëkat që asnjë kinest shqiptar nuk e ka provokuar kjo prozë perlë.

Kuteli e ka edhe një prozë tjetër të mirë “Vjeshta e Xheladin beut”. E di që në vitin 1980 kjo novelë është bërë skenar filmi në TV Prishtinë, por pastaj për shkak të rrethanave të caktuara nuk u bë film. Por do t’i hyja në hak edhe romanit “Ulku dhe Uilli” të Vath Koreshit. Një roman që vonë e kam lexuar me këshillën e mirë të mikut tim Ermir Nika. Do ta fusja në kreun e librave të mirë të letërsisë shqipe.

Cilën vepër do ta hiqnit nga Antologjia e Letërsisë Shqipe?

Janë disa vepra që do t’i hiqja nga Antologjia e letërsisë shqipe, a nga planet e shkollave fillore e të mesme. Janë vepra të mërziutshme, nuk thonë asgjë, nuk kanë vlera letrare artistike, por janë krijuar kaste që i riciklojnë të njëjtët autorë dhe të njëjtat vepra. Kur më treguan para disa vjetësh studentët e mi nga Akademia e Filmit për këto “imponime” më dëshpëruan. Meqë secili student i regjisë së filmit ka obligim të lexojë sa më shumë letërsi shqipe, në mënyrë që të vjelë tema e subjekte për film, u thash ta ndjekin shijen e tyre e jo atë të kritikës zyrtare, apo imponimet e akademive.

Përtej të qenit vetja, kujt prej shkrimtarëve botërorë do të kishit dashur t’i ngjani?

Ernest Heminguejin dhe Erih Maria Remarkun i kisha model, por jo mësues të shkrimit. Pastaj Gabriel Garsia Markezi më mrekullonte me prozën e tij. Hemingueji e Markezi kishin qenë edhe gazetarë, kishin bërë një jetë dinamike nëpër vende të ndryshme.





M

IMAGO

SUPLEMENT
PËR ARTET
PAMORE

“AMAKRES”
Enveri dhe
Mehmeti, piktura
e humbur e
Fatmir Haxhiut

ABAZ HADO

Gjithmonë e kam vrrarë mendjen pse dola piktor

Mes pikturës, grafikës, kritikës letrare, angazhimit në administratë dhe akademi, karriera e Dr. Abaz Hados mbetet shumëdimensionale. E parë nga lartësitë e kohës ajo duket e shkëlqyeshme por stacionet e përshkuara kanë qenë të punës e jo të ndalesave.

ABAZ HADO

Gjithmonë e kam vrrarë mendjen pse dola piktor

Mes pikturës, grafikës, kritikës letrare, angazhimit në administratë dhe akademi, karriera e dr. Abaz Hados mbetet shumëdimensionale. E parë nga lartësitë e kohës ajo duket e shkëlqyeshme por stacionet e përshkuara kanë qenë të punës e jo të ndalesave.

Bëhet nostalgjik kur kthehet pas në kohë. Kujton dhomën e vogël në shtëpinë e tij në Shijak ku flinte me gjyshen. Rrinte deri natën vonë duke vizatuar. Fillimisht kopjonte kopertinat e librave e më pas me ndihmën e mësueses Shpresa Beqiri krijimtaria e tij mori dimension të ri. Do të veçohet nga pjesa tjetër e klasës e do të bjerë në sy, duke u cilësuar nga stafi pedagogjik si njeri me prirje në pikturë. Do të hapë ekspozitën e parë që në klasë të gjashtë e më vonë atë në klasë të tetë, e cila do të bëhet shkak për vijimin e Liceut Artistik në Tiranë.

Ka një moment që i tregoi vërtet vlerën e punës. Ishte në klasën e shtatë kur mori pjesë në një ekspozitë në rrethin e Durrësit. Piktura e tij me një peizazh nga Shijaku u pëlqye shumë dhe u ble me çmimin 2500 lekë, që siç kujton profesori ishte gati e njëjtë me rrogën e babait. “Besoj se kam thyer rekord në atë kohë që një fëmijë të fitojë aq para”, shton me të qeshur. Ngjarjen ia bën edhe më të paharrueshme fakti që e gjitha ndodhi në festat e fund vitit, duke i bërë ato të marrin një kuptim tjetër e të pangjashëm me vitet e kaluara.

Rruga drejt realizimit të ëndrrave, nuk ishte e lehtë. Ishin pengesat financiare që ia bënë të mundimshme ato vite të adoleshencës. Madje kujton se në atë të ftohtë të dimrit të Tiranës mbante të veshur vetëm uniformën e skuadrës së volejbollit të Shijakut.

Pengesë do t’i bëhej shpesh origjina. Edhe pse një familje e thjeshtë punëtore, do të trajtohej sikur të kishte probleme në biografi. Kështu ndodhi kur ishte në vit të katërt në Institutin e Lartë të Arteve dhe i komunikuan se do të qëndronte pedagog. Kjo nuk ndodhi pasi morën vesh se ishte me origjinë çame. Madje donin ta dërgonin në Ishëm, duke synuar kështu shkatërrimin e ambicies dhe të ardhmes.

Profesori tregon se gjatë atyre viteve pati një episod të pakëndshëm me piktorin e njohur, pedagogun Fatmir Haxhiu. Kritika e shprehur ndaj metodave jo aq rezultative për studentët dhe mbrojtja që i bëri shokut të klasës Mikel Gurashi, do të bëhej shkak që Haxhiu të ndryshonte qëndrimin ndaj tij. “Fatmir Haxhiu ishte gjithë ai emër. Ishte buldozeri që mund të të merrte para dhe përplasja me të pati pasoja të rënda.” Një prej këtyre pasojave ishte tentativa për ta mbetur në klasë.

Me përfundimin e studimeve, u kthye në Shijak e më pas Durrës, ku punoi për shumë vite si mësues në shkollën “Jan Kukuzeli”. Auditorëve ku u diplomua do t’iu rikthehej sërish si pedagog, për ta vijuar më vonë karrierën akademike në Universitetin Europian të Tiranës, kompletuar së fundi me titullin profesor i asociuar.

Nuk i është ndarë kurrë dëshirës për të shkruar e për të bërë kritikë arti. E nisi që në vitet e liceut e më pas, duke shkruar në revistat e gazetat e njohura të kohës. E ka bërë përmes monografive të botuara nga Akademia e Shkencave ndër vite, të tilla si: “Guri Madhi, jeta vepra”, “Portreti në pikturë”, “Kostumografia popullore në artin pamor”, “Portreti në skulpturë”. E bën sërish përmes emisioneve televizive ku analizon vepra të ndryshme arti. Ka qenë pjesëmarrës në shumë ekspozita brenda e jashtë vendit, ka marrë pjesë në bienale ndërkombëtare, ka hapur 17 ekspozita personale e veprat e tij gjenden në koleksione të shumta publike dhe private.

Ka mbajtur poste publike drejtuese, duke filluar me atë në Pallatin e Kulturës, më tej si drejtor i Galerisë Kombëtare, për të kaluar pastaj në krye të Galerisë së Artit Tiranë. E ka plotësuar angazhimin e tij me politikë, duke mbajtur postin e zv/ministrit dhe nënkryetarit të bashkisë. Por pavarësisht kësaj, emri i tij mbetet pazgjdhshëmrisht i lidhur me artin e pikturën. “Unë gjithmonë e kam vrrarë mendjen pse dola piktor”, thotë profesori duke dhënë edhe përgjigjen e kësaj pyetjeje gati ekzistenciale.

“Është në gjen. Babai im ishte me origjinë nga Lopsi në Çamëri, një truall artistësh. Nga ky vend kanë dalë Dinejt e famshëm.”

INTERVISTA

Në librin e tij “Shijaku – ky oaz fisnikërie, atdheta-rie dhe humanizmi”, Nikolla Sudar, ish-mësuesi juaj në shkollën 8-vjeçare, kujton se gjatë orës së mësimit ju nxirrni një fletë dhe përhumbeshit në pikturë. Si ka hyrë ky pasion në fëmijërinë tuaj dhe çfarë kujtoni nga ajo periudhë, jo aq e afërt?

Që kur isha fëmijë më pëlqente të blija libra dhe kam pasur ëndërr të kem një bibliotekë, të cilën e kam sot. Blija libra dhe fillimisht iu kopjoja kopertinën. Në klasë të pestë na erdhi një mësuese e shkëlqyer, Shpresa Beqiri, me një pasion të jashtëzakonshëm, e cila na futi në botën e artit. Vizatimi konsiderohej një lëndë dytësore, por ajo e ktheu në prioritet për disa nga ne.

Fillova të punoj pa ndalur. Kisha një dhomë të vogël me gjyshen dhe atje punoja deri në orën dy ose tre të natës. Shpesh herë kam shkuar me duar me bojë në shkollë. Rashë pak nga mësimet, por më trajtonin si djalë me prirje në pikturë. Në klasë të gjashtë bëra një ekspozitë personale me punimet. Pastaj fillova të merrja pjesë në këto rrethet e artit që bënte mësuesja. Kur sapo kishte filluar klasa e shtatë, shkova te piktori i njohur Agim Faja, një nga ilustratorët më të mirë shqiptarë.

A ishte zgjedhja juaj apo e diktuar nga koha vijimi i shkollës së mesme artistike “Jordan Misja” në Tiranë, diplomimi për Pikturë Monumentale në Akademinë e Arteve e më tej specializimi si kritik arti?

Isha përgatitur me Agim Fajën për në lice. Konkurreram disa fëmijë dhe fitues dola vetëm unë. Nga Liceu Artistik një mësues më kishte thënë që je fitues, por emri nuk më kishte ardhur ende. Emrat shkonin në Komitetin Ekzekutiv të Shijakut dhe kryetari nuk kishte thënë gjë fare, pasi unë konkurroja me nipin e tij.

Ndërkohë, në sallën e mësuesve të shkollës vijonte qëndronte e hapur ekspozita që unë kisha hapur me mësuese Shpresën në klasën e tetë. Në ditën e parë të shkollës erdhi Hajro Zeneli, sekretar i partisë në rreth, të cilit i treguan ekspozitën time. Më thërrasin mua e ai më pyet pse nuk kisha vazhduar liceun. I them që kam fituar por nuk kanë ardhur letrat. Thërret kryetarin e Komitetit Ekzekutiv dhe e pyet për dokumentet. Ai shkoi sërish në komitet dhe i sjell dokumentet me justifikimin se kishte rënë poshtë sirtarit. Por ndërkohë mësimi në lice kishte filluar.

U fut komiteti dhe Hajro si garanci që të shkoja pa dokumente në muajin e parë. Ndërsa në të dytin duhet të paguaja lekë. 1840 lekë ishte tarifa e plotë dhe 920 ishte





bursa. Në muajin e dytë dhe të tretë i pagoi babai me familjen. Herën tjetër babai më tha që nuk ka mundësi dhe ideja ishte që të shkëputesha nga shkolla. Meqenëse jetoja me gjyshen (njerka e babait), bëmë gjyq që unë të birësohesha prej saj dhe nga ai moment përfitova bursën. Kjo më dha mundësinë të mbyllja pagesat.

Pas mbarimit të shkollës së mesme bëra një vit stazh. U ktheva në Pallatin e Kulturës në Shijak ku merresha me skenografinë. Doja të studioja për letërsi e të vijoja për kritikë arti, pasi kisha filluar që në lice të shkruaja në disa gazeta të kohës. Vazhdova në Institutin e Arteve për Pikturë Monumentale dhe më vonë për Studiues Arti dhe Kritikë.

Cilët janë mësuesit, pedagogët, piktorët që influencuan në krijimtarinë tuaj të një jete?

Mësuesja Shpresa Beqiri ishte e para që më shtyu fort në këtë drejtim, e më tej piktori Agim Faja. Në Lice kam pasur pedagog në grafikë Skënder Lakon, një djalë i ri që sapo kishe mbaruar studimet. Nga viti i tretë u njoha me kritikun Anton Kuqali, njeri me shumë kulturë, dhe fillova të mësoj shumë pas tij e të merrem me kritikë. Në revistën "Pioneri" kishte një hapësirë për të rinjtë ku unë shkruaja dhe paguhesha njëkohësisht. Ngaqë merresha me kritikë arti fillova të botoja edhe te gazeta "Rinia", gazeta "Drita". Kam botuar disa shkrime për Vangjush Mijon, Sali Shijakun etj.

Si drejtues i Galerisë Kombëtare të Artit (2002-2005) keni pasur mundësinë të shihni më afër problematikat dhe të reformoni institucionin. Nëse do të ishit në të njëjtin post, tashmë pas dy dekadash, cili do të ishte vendimi juaj i parë për institucionin e pikturës?

Në Galeri bëra maksimumin, por më ndihmoi edhe fati. Pata një marrëdhënie të shkëlqyer me drejtorin e Fon-

dit Amerikan të Zhvillimit në Shqipëri dhe gruan e tij, të cilët më ndihmuan të sjell në vendin tonë mënyrën si punohej në SHBA, por edhe të shtoj aktivitetet. Gjatë kësaj kohe u dërgua për restaurim në Francë Motra Tone e Kolë Idromenos, që e quaj si një nga momentet më të bukura gjatë detyrës sime.

Karrierën e kam mbyllur me Galerinë e Artit Tiranë. Sigurisht që do të ngre një galeri tjetër dhe jemi duke punuar për Galerinë e UET. Universiteti European i Tiranës është një universitet që jep mundësi network-u, të jep mundësi të bësh gjëra të vogla, të cilat janë të mëdha për impaktin që kanë.

Jeni angazhuar në politikë me Partinë për Drejtësi, Integritet dhe Unitet dhe keni mbajtur postin e zëvendësministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e më tej atë të nënkryetarit të Bashkisë së Tiranës. Si e kupton një piktor politikën?

Angazhimi im në politikë nuk ka qenë i rastësishëm. Familja ime jo vetëm që është çame, por në familjen time janë vrarë njerëz. Unë kam emrin e një patrioti, Abaz Hamiti, i cili ka qenë i afërm i babit tim. E kisha amanet nga babai që të merrem me këtë punë, por situatat politike këtu te ne janë të tilla që nuk të lejojnë që momente kulmore të historisë të trajtohen si duhet. Çështja çame është shumë e vështirë të zgjidhet.

Politika është domosdoshmëri sepse kështu është ndërtuar sistemi. Nuk e pranoj që asnjë artist të jetë i paangazhuar. Gjithë historia e artit, gjithë veprat e artit, kanë angazhime. Kanë qenë në shërbim të faraonëve, mbretërve, drejtuesve. Sot në artin modern i shërbejnë shoqërisë së ulët, ndërsa artet bashkëkohore i shërbejnë organizimit e çështjeve të tjera. Angazhimet janë kauza të ndryshme, jo vetëm politike, janë mjedisore, etj.

Nga eksperiencia si pedagog keni pasur mundësinë të jeni më afër brezit të ri dhe formimit të tij. Duke pasur parasysh ndikimin e Inteligjencës Artificiale, a mund të konsiderohet sot piktura një profesion?

Me teknologjinë, piktura tani bëhet subjekt vetë. Në Universitetin European të Tiranës kemi filluar përdorimin e saj. Me pedagogun Gejsi Tafa e aplikua për herë të parë në pikturën shqiptare. Në disa degë si dizajni mund të ketë probleme, por nga ana tjetër, e mira është se me AI projektet bëhen më shpejt. Gjithsesi, sado shpikje të bëhen, arti është shpirt, është emocion.

Për dhjetë vite keni drejtuar emisionin “Art Shopping” në News 24 e më tej “Art dhe Art” në RTVSH. Nëse bëni nja balancë, cili ka qenë personazhi apo emisioni që do të veçoni nga të tjerët?

Unë fillimisht kam shkuar si drejtor promovimi në News 24 dhe aty më lindi ideja për të bërë emisionin e artit. Sigurisht që ai pati një impakt sepse rriti nivelin e artit dhe futi për herë të parë ankandet në Shqipëri. Çdo personazh që kam trajtuar ka pasur veçantinë e vet, por ajo që unë veçoj është bërja e analizave. Kam bërë analizën e pikturës “Mbajllja e pemëve” dhe “Epika e yjeve të mëngjesit” dhe të një ekspozite me piktorë të huaj. Sa herë që janë artistë të huaj, të cilët vijnë në original unë e kam kënaqësi pasi më duket sikur jam pjesë e një sipërmarrjeje. Emisioni im është tribuna e vetme që ka mbetur në televizor dhe që bën analiza arti. Prandaj po i reziston kohës.

A ka një ngjarje, një moment që e cilësoni si gabim të jetës suaj?

Pas mbarimit të studimeve, pata një ofertë nga drejtori Fuat Dushku për të më marrë si studiues në Galerinë e Artit, por nuk ia doli dot. Drejtori Alfred Uçi i çoi dokumentet te Instituti i Kulturës Popullore për të më bërë pjesë të tij. Nuk pranova dhe i thashë që kam pasion artin. Aty bëra gabimin e parë. Kjo sepse do të më ndjekin shumë peripeci më vonë. U ktheva nga Tirana në Shijak dhe po prisja emërimin. Mora vesh që kishin planifikuar për të më dërguar në Ishëm. Qëlloi që në atë kohë u hap në Liceun Artistik të Durrësit “Jan Kukuzeli” dega e pikturës dhe më emëruan mësues. I vrrarë isha pasi shpresoja për pedagog, por i marr sfidat shumë butë. Aty gjeta një kolektiv të mrekullueshëm dhe punova me pasion. Bënim aktivitete, thërrisim piktorë, bënim takime. Ka ardhur Kristaq Rama, Guri Madhi etj.

Jeni bërë pjesë e shumë ekspozitave dhe galerive brenda e jashtë vendit. A ka një moment që e veçoni gjatë këtij rrugëtimi?

Kam filluar që në 1983-shin me ekspozitat e para, të cilat kishin sukseset e tyre. Pastaj në '86-ën u hap një ekspozitë në Gjermaninë Lindore dhe ne çuam disa grafika.

Ato ishin pëlqyer shumë dhe unë fillova të dalloj në këtë aspekt. Jam marrë shumë me këto bienalet ndërkombëtare të grafikës dhe kam marrë pjesë në rreth 50 të tilla. Nga 1989-ta deri në 2012-ën kam marrë pjesë rregullisht çdo vit, minimalisht në 3-4 vende të botës. Kam hapur një ekspozitë në Stamboll të titulluar “Shi në Tiranë”, organizuar nga Beste Gursu, kuratorja e Edi Ramës. Ajo ekspozitë me 20 veprat e mia ka mbetur e gjitha në Turqi.

Një moment që më ka dhënë vërtet kënaqësi ka qenë ftesa e një muzeu në SHBA. Ata po bënin një rikonstruktim dhe kishin ftuar 1500 grafistë të botës, mes tyre edhe mua, për të dërguar një punim. U futa në 15-shen e fundit dhe më thanë që jam nominuar për çmim, por nuk fitova. Mund ta quaj ngjarjen më të bukur të jetës sime.

Keni një punim, një pikturë, një galeri personale të pazbuluar për askënd?

Sigurisht që kam. Çdo piktor ka të tilla. Kam bërë më parë portrete të personazheve të ndryshëm që njihja, të femrave, piktura nudo etj.

Një nga pikturat tuaja është pjesë e “Fondit të veprave të artit” të Mbretëreshës së Anglisë. Cila është historia që qëndron pas asaj vepre?

Ka qenë një pikturë për Beratin. Më thotë presidenti Alfred Moisiu, se kur ia dorëzoi mbretëreshës së Anglisë, ajo ishte shumë kurioze dhe e kishte pyetur: “Kështu janë dritaret apo është fantazia e piktorit?” “Jo, ky qytet është i tillë”, i ishte përgjigjur ai.

Cili është mjedisi dhe periudha e ditës që zgjidhni për të krijuar?

Janë disa mjedise në të cilët unë krijoj. Unë kam këtë gjë, që edhe kur jam në universitet, nëse kam një orë të lirë, ulem dhe shkruaj. Në shtëpi kam studio, të cilën e kam organizuar edhe për pikturë edhe për të shkruar. Gjithmonë pas orës dhjetë të darkës deri në orën dymbëdhjetë ose një, ulem për të shkruar. Gjatë ditës jam me aktivitetet e mia, me universitetin, xhirimet e emisioneve, ndërsa pasditet janë gjithmonë për artin.

Nisur edhe nga eksperiencia personale, çfarë këshille u jepni studentëve tuaj që mund t’iu vlejë për të pasur sukses në art?

Ecuria ime ka qenë graduale, por e sigurt, pa kthime pas. Punoja me qetësi dhe seriozitet. Kjo edhe për shkak të natyrës sime. Urtësinë e kam marrë nga babai, ndërsa energjinë nga nëna. Kam qenë modest dhe kam dashur gjithmonë të bëj punën time. Hapësirat vijnë vetvetiu me moshën, me përvojën. Nuk mund ta kërkoj me zor diçka, ti bëj punën tënde. Unë lëvizja nga Shijaku dhe thashë: “Do të iki të luftoj për të qenë dikush”. Edhe studentëve këtë ju them: Nuk duhet të harroni, sukcesi arrihet vetëm me punë dhe këmbëngulje!

HISTORIA E NJË PIKTURE TË ÇMUAR

“Amakres”, Enveri dhe Mehmeti, piktura e humbur e Fatmir Haxhiut

“E sharë, e nëmur, e adhurar – si një pikturë e çmuar”.

Duke perifrazuar vargjet e Mimoza Ahmetit, duket se të gjitha kryeveprat e artit pamor botëror kanë pasur të njëjtin shtegtim: shpesh janë shpërfillur apo anatemuar nga bashkëkohësia, janë lënë në harresë e janë adhurar nga brezat e mëvonë.

Piktura “Amakres” e Fatmir Haxhiut i qëndron kësaj metafore – ndoshta në një rend të përmbytur. Duke portretizuar dy figura të rëndësishme të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe më pas të Partisë Komuniste, që nga dy bashkudhëtarë në atë që do të ishte regjimi më gjakatar, u kthyen në dy armiq... Mbetet një ndër veprat më përfaqësuese të tij – një pasqyrë e ndërthurjes së artit me historinë dhe një dëshmi e fuqisë artistike të realizmit socialist shqiptar. Sot, pavarësisht mungesës së informacionit për pronësinë e saj, ajo mbetet një trashëgimi e çmuar kulturore që meriton të ruhet dhe të studiohet në kuadrin e projektit “100 Piktura të Çmuara në Artin Figurativ Shqiptar, projekti i përbashkët i Aka-

demisë së Studimeve Shqiptare dhe Institutit Liberal Pas-hko, Pas vrasjes së Qemal Stafës, drejtimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë e morën Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, dy figura që do të përcaktonin fatin politik të vendit për më shumë se katër dekada. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ata sollën në pushtet regjimin komunist, i cili më vonë do të njihej si Partia e Punës e Shqipërisë, dhe do ta drejtonin vendin me dorë të hekurt deri në fundin e viteve '80.

Këta dy udhëheqës, që përfaqësojnë një periudhë të errët por historikisht të rëndësishme të Shqipërisë moderne, janë paraqitur në mënyrë simbolike në veprën e piktorit Fatmir Haxhiu, me titull “Amakres” (1943). Në këtë pikturë, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu shfaqen gjatë viteve të fundit të luftës, në një skenë që ngjall idenë e përgatitjeve për marrjen e pushtetit pas largimit të forcave fashiste. Hoxha paraqitet si figura udhëheqëse që jep porosi, ndërsa Shehu si bashkëpunëtori i tij më i afërt, që zbaton me përkushtim planet e tij.

Vepra “Amakres” përfaqëson në mënyrë tipike frymën e realizmit socialist, ku arti shërbente si mjet propagandistik për të glorifikuar udhëheqjen dhe idealet e luftës antifashiste. Megjithatë, përtej dimensionit ideologjik, piktura mbetet një dëshmi e aftësisë së Haxhiut për të trajtuar figura historike me tension dramatik, kompozim të ekuilibruar dhe ngjyra të forta emocionale.

Sot nuk dihet me siguri se kush është pronari aktual i kësaj pikturë, e cila mban firmën autentike të piktorit Fatmir Haxhiu. Si shumë vepra të periudhës së realizmit socialist, edhe “Amakres” mund të ketë kaluar në pronësi institucionale ose private gjatë viteve të tranzicionit, duke e bërë atë një vepër të rrallë dhe të çmuar në historinë e artit shqiptar.

Fatmir Haxhiu (1927–2001), një ndër piktorët më të shquar të realizmit socialist, lindi në Gjirokastrë, por jetën dhe krijimtarinë e zhvilloi në Tiranë. Ai ndoqi studimet e larta në Akademinë e Arteve të Bukura në Zagreb dhe u kthye në Shqipëri i frymëzuar për të kontribuar në zhvillimin e artit figurativ kombëtar. Në vitet '50, Haxhiu themeloi studion e parë të pikturës ushtarake në vend, duke hapur rrugë një tradite të re që do të pasohej nga shumë artistë të rinj.

Veprat e tij u bënë të njohura për publikun shqiptar përmes botimeve në gazetatat dhe revistat e kohës si “Drita”, “Puna”, “Zëri i Popullit” dhe “Ylli”. Për kontributin e tij të veçantë, ai u nderua me titullin “Piktor i Merituar” dhe “Mjeshtër i Madh i Punës.”

Megjithëse një pjesë e mirë e krijimtarisë së tij ishte e lidhur me tematikat e imponuara të kohës, Fatmir Haxhiu diti të ruante ndjeshmërinë e artistit të madh, që përmes ngjyrës dhe dritës i jepte figurës dimension njerëzor dhe emocional.





SUPLEMENT
PËRFEMINIZMIN

MADAME

DRITA KRUIJA
Bëj mirë, pa zhurmë

SEVASTI QIRIAZI
Pionierja e arsimit për vajza

MIRA KAZHANI

Jeta vendosi që të shkruaja një libër



MIRA KAZHANI

Jeta vendosi që të shkruaja një libër

Rrëfimi i Mirës për jetën, sëmundjen dhe rilindjen përmes shkrimit

Ekishte menduar se, pas të pesëdhjetave, do t'i rikthehej një pasioni të hershëm – të shkruarit. Jo në formën e artikujve gazetareskë, por në atë të prozës letrare, e cila deri pak muaj më parë kishte mbetur në kuadër përpjekjesh të pjesshme. Megjithatë, siç ka treguar vetë autorja, ishte jeta ajo që përcaktoi momentin. Shkrimi dhe botimi i një libri erdhi fillimisht si nevojë personale për t'u përballur me përvojën e sëmundjes dhe, më pas, si dëshirë për të ndarë këtë përvojë me gratë që kanë kaluar ose po kalojnë një situatë të ngjashme.


Ky nëntor shënon një vit nga përballja e saj me kancerin – një betejë që ajo e cilëson si të fituar. “Doja të përshkruaja gjithçka që pashë dhe përjetova – si grua, si paciente dhe si gazetare”, është shprehur Kazhani në një prej podcast-eve të saj, ku zbuloi edhe diagnozën që kishte mbajtur për një kohë të gjatë vetëm për vete dhe për disa miq të afërt. Përmes kësaj përvoje, ajo kup-toi se njeriu rrallëherë gjen kohën për të bërë gjërat që dëshiron.

“Një ditë tjetër” lindi edhe nga mungesa e rrëfimeve të ngjashme në gjuhën shqipe nga autore vendase. Kazhani ka theksuar se ndjeu nevojën për të krijuar një hapësirë ku të reflektohej përvojë njerëzore e grave që kanë kaluar sprovat të ngjashme – momente kur jeta rimerr kup-time të reja dhe përditshmëria fiton dimension tjetër.

Në kërkim të këtyre zërave, ajo ka intervistuar gra që ishin në përballje me sëmundjen, disa prej të cilave nuk jetojnë më. Fillimisht kishte planifikuar të përfshinte shtatë rrëfime, por në fund rezultoi se e shtata ishte vetë ajo. Libri ngre pyetje mbi marrëdhënien e njeriut me trupin, shëndetin, sistemin mjekësor dhe mënyrën se si shoqëria përballet me sëmundjen. Përmes këtij botimi, Kazhani ka sjellë një tekst që qëndron në kufirin mes dëshmisë dhe letërsisë. Autorja paralajmëron se udhëtimi i “Një ditë tjetër” nuk përfundon këtu. Gjatë vitit 2025 dhe në fillim të 2026-ës, ajo do të vazhdojë me promovimin e librit jashtë Shqipërisë, ndërkohë që po mendon për një vepër të re.

“Nuk dua të bëj premtime”, thotë ajo, “sepse i pari është shëndeti. Nëse ai është mirë, kemi kohë për çdo gjë tjetër.”

Në një intervistë për suplementin “Madame Mapo”, Mira Kazhani ka folur më gjerësisht mbi



MBI LIBRIN

Nga pikturat e Rembrandt-it në art, "Bathsheba duke bërë banjë", e më tej në letërsinë perëndimore, janë shkruar dëshmi të ndjera të ngjashme. Si askush tjetër deri më tani, Mira ngjyen pendën me kurajë dhe përshkruan emancipimin e femrës shqiptare në përballje me jetën. Duke i hequr kornizën, nën lëkurën e saj Mira ndjen, shpreh, përjeton, duke ditur se për kë flet.

Prof. Mentor Petrela, mjek neurokirurg

Libër që të përpin, që flet për dinjitetin në vuajtje. Me këtë libër, Mira Kazhani hapi një derë për një të nesërme tjetër, për këdo që përballet me vuajtjen, dhimbjen, jetën vetë.

Brunilda Zllami, mjeke dhe shkrimtare

Me një stil të sinqertë e që të çarmatos, Mira Kazhani rrëfen dimrin më të vështirë të jetës së saj. Ajo ka arritur t'u dhurojë lexuesve një reflektim origjinal për jetën dhe kuptimin e saj. Nuk është libër për sëmundjen, aq sa një filozofi e përballje me humbjen. Ky libër është fëmija i Mirës.

Ilva Tare, gazetare

Një rrëfim që merr zë nga thellësia e vetes dhe që flet në emër të të gjithëve mbi dualizmin e të panjohurave të mëdha, si njeriu dhe sëmundja, femra dhe identiteti, mjekësia dhe shoqëria. Përmes syve të Mirës shoh dyzimin, dyshimin, dy jetët e të gjitha grave që takoj çdo ditë të punës sime.

Majlinda Ikonimi, mjeke anatomo-patologe

procesin e shkrimit, përvojën personale që e frymëzoi dhe planet për të ardhmen në fushën e letërsisë. Për të, jeta mbetet materiali më i fuqishëm i rrrëfimit, shpeshherë më i thellë se çdo trill letrar.

Pse ky libër?

Sepse ky libër ndodhi. Nuk më pyeti. Ndodhi para se të shkruhej.

Pse kjo hyrje në skenën letrare?

Nuk e kam parë si një hyrje në skenën letrare. Nuk bëra plane me këtë libër. U nisa me idenë e një libri të nevojshëm.

do ta thosha, do lëndoja shumë gra të tjera që janë në pozitën time, ashtu siç jam ndër e lënduar dhe e shqetësuar unë.

Në Shqipëri gjërat janë ngatërruar shumë. Dhe një sistem shëndetësor i dësh-tuar ka bërë që disa njerëz të humbasin toruan. Mjekësia si biznes e ka dërrmuar raportin njerëzor midis mjekut dhe pacientit.

Çfarë do të shkruash në vitin 2026?

Nuk do e lë kaq shpejt udhëtimin e "Një ditë tjetër"...



Rrugës doli letërsia. Ëndrra ime e vjetër.

Mund të kishe zgjedhur fiction. Pse rrëfeve një ngjarje reale?

Sepse jeta ia kalon imagjinatës. Jeta ime, më 2 nëntor të vitit 2024, ia kaloi çdo fantazie. Erdhi fillimisht si një pabesi dhe përfundoi në letërsi. Vetëm jeta reale ka këtë fuqi.

Eksperiencia, përjetimi total dhe rrëfimi janë një te "Një ditë tjetër", por a ka mbetur diçka pa thënë?

Po, ka një episod fatal me dikë, por që kam vendosur ta mbaj për vete. Të paktën në këtë libër, në këtë moment. Sepse, nëse

Deri në fund të pranverës jam në një kalendar promovimi të librit jashtë Shqipërisë. Nuk e kisha menduar që do të shkonte kështu, por libri vendosi fatin e vet dhe unë duhet ta ndjek.

Do të shkruaj patjetër. E kam edhe idenë. Dhe besoj se do jem sërish te realiteti i veshur me letërsi. Më pëlqen jeta më shumë sesa fantazia për të. Më pëlqen të shkruaj për ngjarje të jetuara.

Por mbi të gjitha, nuk dua të bëj premtime dhe i pari është shëndeti. Nëse ai është mirë, kemi kohë për çdo gjë tjetër.



DRITA KRUJA

Bëj mirë, pa zhurmë

..sepse mirësia dhe ndershmëria kanë zë edhe kur heshtin

Rektorja e Universitetit European të Tiranës rrëfen veten përtej akademikes: tiparet, sekretet dhe recetën e saj të lumturisë.

1- Cila është ideja e juaj për lumturinë e përkryer?

Lumturia për mua është qetësia e shpirtit që vjen kur jeton me ndershmëri, rrethuar nga familja dhe njerëzit që do, duke ditur se ke bërë më të mirën tënde dhe ke ruajtur emrin e mirë.

2- Cila është frika juaj më e madhe?

Të humbas njerëzit e dashur ose të zhgënjeh dikë që më beson.

3- Cilin person të gjallë e admironi më së shumti?

Admiroj njerëzit që kanë arritur sukseste pa humbur thjeshtësinë dhe integritetin, ata që punojnë me përkushtim, pa zhurmë dhe me ndershmëri.

4- Cili është personaliteti historik më të cilin do të dëshironit të identifikoheshit?

Me një figurë që i ka shërbyer njerëzve me përlësi dhe dinjitet, si Nënë Tereza.

5- Cili është tipari i juaj që nuk e pëlqeni?

Ndonjëherë jam tepër kërkuese me veten dhe me të tjerët.

6- Cili është tipari të cilin nuk e pëlqeni tek të tjerët?

Hipokrizia dhe mungesa e sinjeritetit, kur njerëzit flasin ndryshe nga ajo që mendojnë.

7- Në cilat gjëra e teproni?

Në përgjegjësi dhe perfeksionizëm. Ndonjëherë nuk di të ndalem derisa çdo gjë të jetë në nivelin që dua.

8- Çfarë do t'iu shtynte të gënjenit?

Vetëm për të mbrojtur dikë nga dhimbja apo për të shmangur një padrejtësi të panevojshme.

9- Cili është rrugëtimi juaj i preferuar?

Rrugëtimi im i preferuar është ai drejt qetësisë së detit.

10- Cilën fjalë apo frazë e përdorni më së shpeshti?

"Gjithçka kthehet" sepse besoj se jeta ruan ekuilibrin e saj: çdo gjë që jep me ndershmëri, mirënjohje dhe mirësi, të kthehet në një formë apo tjetër.

11- Për çfarë ju ka ardhur më së shumti keq apo jeni penduar që e keni bërë?

Për momentet kur kam duruar më shumë se duhej, duke besuar se të tjerët do të ndryshonin me kohë.

12- Çka ose kush është dashuria juaj më e madhe e jetës?

Familja, sepse aty gjendet forca, qëndrueshmëria dhe kuptimi i jetës.

13- Cila është gjendja momentale mendore e juaja?

Si deti që më përfaqëson herë e qetë, herë e trazuar, por gjithmonë e mbushur me reflektim e mirënjohje.

14- Nëse do të kishit mundësinë të ndryshonit vetëm një gjë tek vetvetja, cila do të ishte ajo?

Do të doja të isha më pak vetëkritike dhe të lejoja veten të pushoj më shpesh.

15- Çfarë konsideroni të arriturën tuaj më të madhe?

Ruajtja e integritetit dhe emrit të mirë në çdo etapë të jetës personale dhe profesionale.

16- Nëse do të mund të kthenit kohën, çfarë do të ndryshonit?

Ndoshta do të isha më e kujdesshme me besimin që u kam dhënë disa njerëzve.

17- Nëse do të vdisnit dhe do të kishit mundësinë të ktheheshit qoftë si njeri apo send, çfarë personi apo sendi do të zgjidhnit të jeni?

Një pemë në një kopsht familjar që jep hijen dhe frytet e saj pa kërkuar asgjë në këmbim.

18- Cila është gjëja më e shtrenjtë që e posedoni?

Emri i mirë dhe besimi i njerëzve që më rrethojnë.

19- Çfarë konsideroni si mjerimin më të madh?

Të jetosh pa dashuri, pa ndershmëri dhe pa ndërgjegje.

20- Ku do të dëshironit të jetonit?

Në një vend të qetë buzë detit, ku dall-gët sjellin paqe dhe çdo ditë nis pranë familjes, natyrës dhe njerëzve me shpirt të pastër.

21- Cila është cilësia juaj më e veçantë?

Aftësia për të mbajtur fjalën dhe për të qëndruar e sinqertë edhe në situatat më të vështira.

22- Çfarë vlerësoni tek një burrë?

Ndërgjegjen, dinjitetin dhe qëndrueshmërinë morale.

23- Çfarë vlerësoni tek një grua?

Forcën, ndershmërinë dhe aftësinë për të dashur pa kushte.

24- Cili është shkrimtari i juaj i preferuar?

Stefan Zëeig (Cvajg) për ndjeshmërinë e thellë njerëzore, përshkrimin e ndjenjave me elegancë dhe për mënyrën si zbulon luftën e brendshme mes arsyes, pasionit dhe moralit.

25- Cilët janë heronjtë tuaj në jetën e vërtetë?

Njerëzit e thjeshtë që punojnë ndershëm, rrisin me dashuri fëmijët dhe mbeten të mirë në një botë që shpesh nuk është e tillë.

26- Cilin talent do të dëshironit ta kishit?

Të dija të pikturoja për të shprehur ndjenjat që fjalët ndonjëherë nuk i shprehin dot.

27- Si do të dëshironit të vdisnit?

E qetë, si deti pas perëndimit, në paqe me veten dhe e rrethuar nga njerëzit që dua.

28- Cila është motoja juaj?

"Bëj mirë, pa zhurmë", sepse mirësia dhe ndershmëria kanë zë edhe kur heshtin.



SEVASTI QIRIAZI

Pionierja e arsimit për vajza

Një nga figurat më të rëndësishme të feminizmit shqiptar. Ajo hap shkollën e parë për vajza në qytetin e Korçës në vitin 1891 dhe hartoi tekste shkollore në gjuhën shqipe. Në një kohë kur edukimi i vajzave ishte shumë i kufizuar, ajo luftoi për mundësi të barabarta për gratë shqiptare.

Në një kohë kur Shqipëria po kalonte periudhën më të vështirë të sundimit osman, dhe gratë ishin të mbërthyera në një sistem patriarkal ku mundësitë për arsimim dhe zhvillim ishin të kufizuara, një grua e guximshme ngriti zërin dhe e sfidoi këtë rend të padrejtë: Sevasti Qiriazi. Ajo do të bëhej një figurë kyçe në lëvizjen feministe shqiptare dhe do të sillte një revolucion të heshtur, por të fuqishëm, për arsimin dhe emancipimin e grave.

Në fund të shekullit të 19-të, Shqipëria ishte ende një shoqëri ku gratë e vajzat ishin të izoluar, shumica e tyre të mbyllura brenda kuadrin të traditës dhe zakoneve që kufizonin mundësitë për zhvillim. Shkollat, të cilat ishin kryesisht të menaxhuara nga misionarët dhe autoritetet osmane, ishin shumë të paktë dhe, në shumicën e rasteve, ishin të orientuara në arsimimin e djemve, duke i përjashtuar vajzat.

Sevasti Qiriazi, lindi rreth vitit 1870 në qytetin e Manastirit, një qytet i rëndësishëm i periudhës osmane, ku shkollimi i vajzave ishte një luks që shumë familje nuk mund ta përballonin. Pas arsimimit të saj në shkollë të huaja, dhe pas një përvoje të thelluar për edukimin dhe rolin e gruas, Sevastia kuptoi se arsimit ishte një nga mjetet më të fuqishme për të nxjerrë gruan shqiptare nga hijet e mungesës së mundësive dhe izolimit.

Më 1891-shin, ajo ishte e para grua shqiptare, e cila diplomoi në kolegjin amerikan "Robert College" në Stamboll.

Po atë vit, me ndihmën e motrës së saj Parashqevi, dhe një mbështetje të madhe nga patrioti i shquar Naim Frashëri, arriti të krijonte një shkollë të dedikuar për vajzat në qytetin e Korçës. Kjo shkollë do të shënonte një hap të rëndësishëm në historinë e arsimit shqiptar dhe të lëvizjes feministe në Shqipëri: ishte shkollë e parë për vajza, ku ato mund të mësonin jo vetëm gjuhën shqipe, por edhe lëndë të tjera si historia, gjeografia dhe kultura shqiptare.

Krijimi i kësaj shkolle ishte shumë më tepër se thjesht një hap për arsimin. Ishte një akt i fuqishëm i disidencës ndaj një sistemi që kishte përbuzur dhe shtypur gratë për shekuj me radhë. Sevastia e kuptoi se edukimi ishte mënyra më e fuqishme për të thyer zinxhirët që e mbanin gruan shqiptare të lidhur në rolin e saj të pasivitetit dhe pasivizmit.

Edukimi i vajzave në Shqipëri në ato vite ishte një sfidë shumë e madhe, pasi jo vetëm që duhej të luftohej kundër një ambienti patriarkal, por gjithashtu duhej të tejkaloheshin edhe rezistenca e fortë e shumicës së prindërve, të cilët nuk e shihnin me sy të mirë edukimin e vajzave. Pavarësisht këtyre sfidave, Sevastia dhe motra e saj, Parashqevia, arritën të hapnin dyert e shkollës për vajzat, duke ofruar mundësi që ishin të papara deri në atë kohë.

Sevasti nuk ishte vetëm një mësuese; ajo ishte një luftëtare për të drejtat e gruas dhe barazinë gjinore. Ajo hartoi libra dhe tekste shkollore që ishin të dedikuara për edukimin e vajzave shqiptare, duke i

mundësuar atyre të kuptonin dhe të shpërthenin kufizimet e vendosura nga shoqëria. Një prej veprave të saj më të njohura ishte "Gramatika elementare për shkollat fillore", e cila e bëri gjuhën shqipe një objekt mësimi të vlefshëm dhe të njohur për vajzat shqiptare.

Në ato vite, kur shumë burra shqiptarë shihnin edukimin si një domosdoshmëri për zhvillimin e kombit, Sevastia dhe Parashqevia ishin ndër të parat që e shihnin edukimin si një armë të fuqishme për ndryshimin social dhe kulturor. Ato jo vetëm që i dhanë mundësinë vajzave të studiojnë, por gjithashtu i mësuuan ato të mendojnë mënyrë kritike dhe të rrezikojnë të mbrojnë të drejtat e tyre.

Në vitin 1912, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, Sevastia u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi punën e saj edukative. Edhe pse ishte detyruar të largohej gjatë Luftës së Parë Botërore, ajo kurrë nuk ndali kontributin e saj për emancipimin e gruas shqiptare dhe për zhvillimin e arsimit të saj. Ajo luftoi për të siguruar që gratë të kishin mundësinë të zhvilloheshin në çdo aspekt të jetës dhe se nuk duhej të ishin të izoluar në role të kufizuara dhe të varfra.

Në periudhën e pas Luftës, kur Shqipëria u përball me një periudhë të vështirë rindërtimi dhe zhvillimi, ajo vijoi të mbështeste arsimin, duke përfshirë dhe vajzat në çdo nivel edukimi. Përpjekjet e saj arritën kulmin e tyre kur ajo u bë një simbol i lëvizjes feministe shqiptare dhe e arsimit të vajzave, duke u nderuar postum si hero i kombit.



UETPRESS



$$(a+b)^n = \sum_{k=0}^{k=n} \binom{n}{k} a^{n-k} b^k$$

4, 5, 6
20 25 2

4. 1. 4



Me studime
e numra t' shkruara
Kot na shkues
Të rit e jeta, Ë

750

LIBRA
TË BOTUAR

50

LIBRA
NË VIT

5

KOLANA